

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI JURIDIK  
LAW FACULTY  
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

## STUDIME POSDIPLOMIKE

Teza e magjistraturës

**“ Definimi ndërkombëtar i krimeve kundër njerëzimit,  
Kosova e viteve 1997-2000”**

**Kandidat:**

Armend Ademi

**Mentor:**

Prof. dr. Besa Arifi

**Tetovë, 2020**

## **Përmbajtja**

Përmbajtja .....	2
HYRJE .....	4
KAPITULLI I .....	5
ZHVILLIMI HISTORIK DHE ASPEKTI JURIDIK I KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT.....	5
1. 1. Vështrim i përgjithshëm dhe historiku i krimeve kundër njerëzimit .....	5
1.2. Aktet kriminale që përbëjnë krimet kundër njerëzimit ose format e krimeve kundër njerëzimit .....	9
KAPITULLI II .....	15
KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT SIPAS GJYKATAVE NDERKOMBETARE PENALE .....	15
2. 1 Gjykata Ndërkombëtare e Nyrembergut dhe Tokios .....	15
2. 2. Gjykata Ndërkombëtare e Hagës .....	19
2. 2. 1. Vendimi Tribunalit të Hagës për të kryer hetime edhe në Kosovë.....	21
2. 2. 2. Statuti i Tribunalit të Hagës .....	22
2. 3. Gjykata Penale Ndërkombëtare në Ruandë dhe Sierra Leone .....	23
2. 4. Gjykata e përhershme Penale Ndërkombëtare .....	25
2. 4. 1. Statuti i gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare .....	26
2. 4. 2. Veprat penale që janë kompetencë e kësaj gjykate .....	26
2. 4. 3. Dënimi dhe ekzekutimi i tyre .....	27
2. 4. 4. Struktura dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i gjykatës.....	28
KAPITULLI III .....	30
KRIMET KUNDER NJERZIMIT NË KOSOVËN E VITEVE 1997-2000 .....	30
3.1. Shkaqet e fillimit të Luftës në Kosovë.....	30
3.2. Fillimi i Luftës së Kosovës.....	32
3.3. Masakrat dhe krimet kundër njerëzimit në Kosovën e viteve 1997-1999 .....	33

3.3.1. Masakra e Çukisë dhe Ljubeniçit .....	33
3.3.2. Masakra e Reçakut.....	35
3.3.3. Masakra e Burgut të Dubravës .....	36
3.4. Numri i viktimave në Kosovën e viteve 1997-1999.....	37
3.5. Intervenimi i NATO-s në Kosovë.....	40
KAPITULLI IV.....	44
SHKATËRRIMI I ISH-JUGOSLLAVISË, KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT, KRYERËSIT E TYRE DHE DËNIMET NGA GJKATA E HAGES PËR SHTETET E ISH JUGOSLLAVISË .....	44
4.1. Shpërbërja e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë .....	44
4.2. Krime kundër njerëzimit në Bosnjë Hercegovinë .....	46
4.2.1. Masakra e Srebrenicës .....	48
4.2.2. Numri i viktimave nga Lufta e Bosnjë Hercegovinës (sipas gjinisë, rajonit dhe komunave).....	49
4.3. Krime kundër njerëzimit në luftën e Kroacisë .....	51
PËRFUNDIMI .....	54
BIBLIOGRAFIA .....	55

## HYRJE

Kur një person fizik është viktimë e një vepre penale ai me automatizëm është i cenuar, gjë që e detyron atë të kthehet e të shikojë në sistemin e drejtësisë me të vetmen shpresë që një ditë të mund të kthejë atë që ka humbur. E njëjta gjë ndodh edhe me krimet që vëllimin e kanë më të madh, raste këto që prekin një grup më të madh njerëzish e që i detyron ato të ndjehen të viktimizuar e të cenuar. Shoqëria mbarë njerëzore ka nevojë të dijë se me të vërtetë ekziston drejtësia, bilanci brenda drejtësisë dhe se kryerësit e këtyre veprave makabre nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar. Krahas krimeve të luftës dhe gjenocidit ekzistojnë edhe krimet kundër njerëzimit që bashkërisht përbëjnë veprat më të rënda penale kundër shoqërisë, që ndryshe njihen si vepra penale ndërkombëtare.

Trajtimi i rasteve ku është vërtetuar se ka krime kundër një grupi shoqëror llogaritet si test i rëndësishëm për të vërtetuar besueshmërinë e sistemit të drejtësisë, pasi që shumë faktorë kontribuojnë në këtë, edhe atë: zgjedhja e gjykatësve të paanshëm, vështirësitë për vërtetimin e aktakuzave, përputhja e hetimeve të kryera nga organizata të shumta, përputhja e normave dhe ligjeve vendore me ato ndërkombëtare, etj.

Gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës kërkojnë dhe meritojnë të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe precize. Pikërisht për këtë, tema për të cilën do të flasim në këtë punim ka të bëjë me definimin e krimeve kundër njerëzimit e cilat vepra llogariten si të tilla, trajtimin ndërkombëtar të krimeve kundër njerëzimit qysh pas Luftës së Parë Botërore, themelimin e Gjykatave Ndërkombëtare për ndëshkimin e kryerësve të veprave penale, krimet e kryera gjatë shkatërrimit të Jugosllavisë, ndërsa me theks të veçantë do të njihemi me krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë në periudhën para dhe gjatë luftës që përfshin periudhën prej vitit 1997 deri në vitin 2000. Në këtë punim assesi nuk do të mungojnë edhe disa nga masakrat e shumta e të njohura ndërkombëtarisht. Përveç krimeve në Kosovë në këtë punim do të përfshihen edhe krimet kundër njerëzimit në dy luftërat më të frekuentuara të ish Jugosllavisë siç është ajo e Kroacisë dhe Bosnjë Hercegovinës ku nuk do të mungojë edhe numri i përgjithshëm i viktimave të dala nga këto lufta.

Qëllimi kryesor i hulumtimit të kësaj teme qëndron pikërisht në studimin e përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit, themelimi, roli dhe mënyra e funksionimit të gjykatave penale ndërkombëtare, e në veçanti analizimi i luftës së Kosovës, krimet e kryera nga ushtria serbe kundër popullit civil.

# KAPITULLI I

## ZHVILLIMI HISTORIK DHE ASPEKTI JURIDIK I KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT

### 1. 1. Vështrim i përgjithshëm dhe historiku i krimeve kundër njerëzimit

Historikisht ekzistojnë shumë dilema që kanë të bëjnë me nocionin e veprave penale ndërkombëtare të cilat për fat të keq janë prezentë edhe në kohën e sodit për shkak se edhe sot e kësaj dite interesat politike janë faktorët kryesorë për realizimin e krimeve të rënda ndërkombëtare nga e cila përfitojnë vetëm një grup i vogël njerëzish të cilët realizojnë ëndrrën e tyre-qëndrimin në pushtet. Nocionin e veprës penale ndërkombëtare e njeh shkenca e së drejtës penale ndërkombëtare mirëpo fatkeqësisht nuk llogaritet si përkufizim i tërësishëm dhe preciz. Mos preciziteti i këtij nocioni ekziston edhe sot e kësaj dite dhe vjen si pasojë e kriminalitetit ndërkombëtar të realizuar nga shtetet veç e veç. Përkufizimi i veprës penale ndërkombëtare paraqitet në llojin e karakterit sociologjik-kriminologjik dhe karakterit juridiko-penal. Duke u bazuar në aspektin juridiko-penal, veprat penale ndërkombëtare duhet të ndalohen duke u bazuar në norma juridike, në bazë të së cilit vepra penale llogariten të gjitha ato vepra të cilat janë të parapara me ligj.

Në Traktatin e Parisit të vitit 1814, ndërmjet Britanisë së Madhe dhe Francës kanë përdorur formulimin *parimet e drejtësisë natyrore*, dhe fuqitë e mëdha si, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë deklaruar në Traktatin e Gentit në vitin 1814, që tregtia me skllevër ka shkelur në *parimet e humanizmit dhe drejtësisë*.<sup>1</sup> Deklarata multilaterale e këtyre fuqive, për zhdukjen e tregtisë me njerëz, respektivisht skllevërve, prej datës 8 Shkurt të vitit 1815 përfshiu në fjalinë e parë konceptin mbi *parimet e humanizmit dhe të drejtat universale* si justifikim për t'i dhënë fund kësaj tregtie që ishte e padurueshme në vazhdimësinë e saj.<sup>2</sup> Ky term filloi të përdoret në Konventën e Hagës në vitin 1907 në preambulën e saj, e cila kodifikoi të drejtën zakonore të konflikteve të armatosura. Ky kodifikim u bazua në praktikat ekzistuese të shteteve të ndryshme të cilat rrodhen nga vlera

---

<sup>1</sup> Martin, Francisco Forrest (2007). *The Constitution as Treaty: The International Legal Constructionalist Approach to the U.S. Constitution*. Cambridge University Press. p. 101

<sup>2</sup> Baldwin, Cradock & Joy, The Parliamentary debates from the year 1803 to the present time... Vol. 32, 1 February - 6 March 1816. 1816 Shih: <https://www.royalcollection.org.uk>

dhe parime që u konsideruan si formuese të "ligjeve të njerëzimit", siç pasqyrohet në të gjithë historinë e kulturave të ndryshme.<sup>3</sup>

Veprat penale ndërkombëtare ndahen në dy pjesë, në vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e gjerë dhe vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e ngushtë. Tortura, trafikimi me njerëz, falsifikimi i parasë, larja e parasë, tregtia me publikime të pamoralshme, tregtia me narkotik, etj., të gjitha këto bëjnë pjesë në grupin e veprave penale ndërkombëtare në kuptimin e gjerë. Krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidi, luftërat agresive, dhe shkelja e zakoneve të luftës, të gjitha këto llogariten si vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e ngushtë.

Vlerat demokratike hashin në vështirësi të mëdha, mirëpo paraqitja e të njëjtave ishte bindshëm në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Evropës Lindore. Këto vlera bëheshin edhe më të vështira kur merreshin hapa për themelimin e strukturave të sistemeve demokratike. Bashkimi Sovjetik kishte përvojë të hatashme në krahasim me vendet tjera, pasi që u krijua pas Revolucionit Socialist që integroi sistemin komunist në Rusi në vitin 1917. Sistemi komunist ishte vendosur në shumë vende të botës, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, mirëpo përvoja dhe eksperiencia ishte sistemi komunist i Rusisë së vitit 1917. Fillimi i fundit të sistemit komunist erdh diku në vitet e fundit të shekullit XX, që ndryshe njihen edhe si vite revolucionare ku do të vinte edhe fundi i Luftës së Ftohtë. Ky revolucion filloi me dy fuqitë më të mëdha botërore respektivisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Rusinë, ku zgjedhjet në Amerikë i kishte fituar Ronald Regani, i cili pas përpjekjeve të mëdha marrëdhëniet armiqësore i shndërroi në marrëdhënie miqësore, ndërsa në Rusi në krye të shtetit kishte ardhur Gorbaçovi pas një lufte të ashpër kundër sistemit komunist. Rënia e komunizmit që llogaritet e papritur ndodhi kur në botë mbretëronte bindja se ky sistem përgatitet të përmbyste çdo gjë që mund të quhej mënyrë demokratike e jetës shoqërore.<sup>4</sup> Fitues i Luftës së Ftohtë doli Amerika falë politikës së jashtme të jashtëzakonshme të Reganit, të cilit iu deshën më shumë se 40 vjet përpjekje dhe sakrifica politike dhe ekonomike për të shkatërruar sistemin komunist.

Pas luftës së dytë botërore duke llogaritur në këtë 50 vjetorin e fundit të ekzistimit të botës, e drejta penale ndërkombëtare ka pasur një zhvillim të hovshëm, zhvillim i cili dukshëm shihet nëse krahasojmë statutin e gjykatës penale ndërkombëtare të Nyrnbergut

---

<sup>3</sup> M. Cherif Bassiouni, Crimes against Humanity: Historical Evolution and Contemporary Application, Cambridge University Press, 2011, 845 pages.

<sup>4</sup> Intervenimi i Natos në Kosovë, Nusret Pllana, Prishtinë, 2010, faqe 32.

dhe Tokios me statutin e Tribunalit të Hagës për të cilat do të flasim më vonë. Këto ndryshime do të zhvillohen edhe më vonë me përpilimin e statutit të gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare e cila gjithashtu është e vendosur në Hagë.

Shprehja *krime kundër njerëzimit* nuk është i ardhur nga Ministri rus i Punëve të Jashtme Sazonov, në vend të kësaj ai propozoi një protestë kundër *krime kundër krishterizmit dhe civilizimit*.<sup>5</sup> Mirëpo Ministri për Punë të Jashtme i Francës z. Delcasse parashtroi pyetjen që kanë të bëjnë me krimet kundër krishterimit. Ai frikohej se popullata myslimane që ishin nën sundimin e Francës dhe Britanisë së Madhe do të hidhëroheshin nga një shprehje e tillë dhe pikërisht për këtë ata do të ndiheshin të diskriminuar. Prej këtu ai propozoi që në vend të termit *krime kundër krishterizmit* të përdoret termi *krime kundër njerëzimit*, këtë propozim e pranuan edhe ministrat e punëve të Jashtme të Rusisë dhe Britanisë së Madhe dhe e futën në Deklaratën e përgjithshme.

Ngjashëm me këtë komisioni veçantë i themeluar pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore në Deklaratën e saj deri te Konferenca e Versajës propozoi që të themelohej një Gjykatë ndërkombëtare për krimet dhe kompetencat juridike të saj të jenë të zgjeruara në *krime kundër ligjeve të njerëzimit*.<sup>6</sup>

Krimet kundër njerëzimit janë të vjetra sa edhe vetë njerëzimi, mirëpo e drejta ndërkombëtare krimet kundër njerëzimit ka filluar ti trajtojë diku afërsisht para 70 viteve, por më saktësisht kristalizimi i definicionit dhe masave të ndërmarra kundër krimeve të njerëzimit zhvillim të hovshëm ka në njëzet vjetorin e fundit. Duke u bazuar në të kaluarën më të largët referenca kryesore në lidhje me krimet kundër njerëzimit si një koncept legjitim paraqet një deklaratë të përbashkët nga ana e Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë në vitin 1915, e sjellë si përgjigje pas masakrës së kryer ndaj Armenëve nga ana e Turqve, ku deklarata e përbashkët ndër vete përmban termin *krimet kundër njerëzimit dhe civilizimi*.<sup>7</sup>

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Këshilli i atëhershëm ndërkombëtar për krime lufte propozoi që të formohet një tribunal ndërkombëtar i cili nuk do të ishte përgjegjës vetëm për gjykimin e krimeve të luftës por edhe për gjykimin e rasteve ku do të bëhej shkelja e ligjeve humane, megjithatë përfaqësuesi i atëhershëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë këshill ndërkombëtar e kundërshtoi këtë propozim me të vetmen arsye se referencat e

<sup>5</sup> Меѓународно кривично право, Антонио Касезе, Скопје 2009, стр. 102.

<sup>6</sup> Меѓународно кривично право, Антонио Касезе, Скопје 2009, стр. 102.

<sup>7</sup> Вовед во меѓународно кривично право и кривича процедура, Роберт Крајер, Хакан Фриман, Дерил Робинсон, Елизабет Вилмсхерст, Табернакул, 2010, стр. 190.

ligjeve të atëhershme humane nuk kishin arritur në atë shkallë të precizitetit që të njiheshin si ligje kriminele.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, definimi mbi krimet kundër njerëzimit filloi të zhvillohet edhe më shumë, me definicionet e kohëve më të lashta kundër krimeve të luftës, nuk kishte ndër vete krime të kryera nga ana e një qeverie mbi popullin e vet. Pikërisht kjo filloi të zbatohet në Gjykatën e Nyrnbergut ku u përmend edhe referenca *mbi cilëndo popullatë civile* që nënkupton se do të dënohet dhe gjykohet edhe çdo përfaqësues i një qeverie që kryen krime kundër popullit të vetë civil. Kjo paraqet një hap përpara duke marrë parasysh edhe faktin se në atë kohë e drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut si pikë kryesore e ka pasur zgjedhjen e konflikteve ndërmjet dy apo më tepër shteteve. Deri në atë kohë e drejta penale ndërkombëtare, krimet kundër njerëzimit i ka llogaritur që mund të ndodhin vetëm në ndonjë konflikt të armatosur. Gjykata e Tokios ndër vete inkadroi një definicion të ngjashëm me atë të Nyrnbergut, ku i ashtuquajturit Këshilli Kontrollues i Aleatëve i cili ishte i detyruar të krijojë një ligj mbi Gjermaninë e okupuar e pranoi këtë definicion dhe në listën e veprimeve johumane shtoi edhe përdhunimin, torturën dhe robërimin, dhe nuk anashkalonte lidhshmërinë me krimet e luftës. Zhvillimi historik i krimeve kundër njerëzimit do të vazhdojë me themelimin e një gjykate e cila do të merrej me krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, ngjashëm me këtë u themelua edhe një gjykatë për krimet e kryera në Ruandë. Burime shtesë në lidhje me definimin e krimeve kundër njerëzimit mund të gjenden tash edhe në sferën tribunale të shkencave juridike si dhe në instrumentimin e tribunaleve tjera (Irak, Sierra Leone).

Krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit mund të paraqiten edhe në formë reciproke të cilën edhe shpesh e bëjnë, për shembull, vrasjet masive të civilëve gjatë kohës së konflikteve të armatosura mund të jenë si krime të të dyja tipave. Megjithatë ndërmjet tyre ekzistojnë edhe dallime, së pari për dallim nga krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit mund të paraqiten edhe kur nuk ka konflikt të armatosur. Si e dyta krimet kundër njerëzimit nënkuptohen si kontekst më i zgjeruar apo i sistematizuar ndërkaq edhe një incident i vetëm mund ti përmbush kriteret dhe të llogaritet si krim lufte, dhe si e treta ligji për krimet e luftës merret me veprat penale të kryera në fushëbetejë të cilat kuptohet se janë të ndërlidhura me domenin e luftës, ndërkaq ligji për krimet kundër njerëzimit merret me krimet e kryera ndaj popullatës civile. Nga këtu mund të konkludojmë se interesi i bashkësisë ndërkombëtare për krimet e luftës del nga realiteti i konflikteve të armatosura, ndërkaq për krimet kundër njerëzimit del nga sulmi mbi popullatën civile.



Edhe gjenocidi llogaritet si një nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, duke u bazuar në faktin se paraqet një krim të kryer me qëllim të qartë për shkatërrim të plotë apo të pjesërishtëm etnik apo racor të një grupi. Për disa raste me kalimin e kohës definicionet e të dyja krimeve përjetojnë ndryshime të cilat ndër vete përmbajnë edhe kërkesa të reja, për këtë arsye gjenocidi paraqitet edhe si pjesë e krimeve kundër njerëzimit, nga ana tjetër secili shembull ekzistues për gjenocid i përmbush kriteriumet të paraqitet edhe si krim kundër njerëzimit.

## **1.2. Aktet kriminale që përbëjnë krimet kundër njerëzimit ose format e krimeve kundër njerëzimit**

Sjellja e ndaluar më afër ishte e sqaruar në marrëveshjen e Londrës të vitit 1945 dhe ngjashëm në ligjin e këshillit kontrollues, në Gjykatën Penale Ndërkombëtare të Tokios, Gjykatën Ndërkombëtare për krime në ish-Jugosllavi dhe Gjykatën Ndërkombëtare për krime në Ruandë. Kategori të ndryshme më gjerësisht ishin të vendosura në nenin 7 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare për krime prej të cilëve një përqindje e madhe mund të kristalizohen ose të kodifikohen një numër i madh prej të drejtës ekzistuese.<sup>8</sup>

Tash, Gjykata Ndërkombëtare për krime në raport me krimet që janë lëndë për shqyrtim gjithmonë kërkon një kontekst të përgjithshëm të sjelljes kriminale që përbëhet prej krimeve të kryera në mënyrë sistematike apo të gjerë antiligjore kundrejt popullatës civile. Nga ky kontekst ekzistojnë format e mëposhtme të krimeve që paraqesin krime kundër njerëzimit edhe atë:

- *Vrasjet* – si rregull i elementit mental të kësaj sjelljeje është qëllimi që të sjellë vdekjen e personit tjetër. Me vrasje nënkuptojmë atë veprë të kundërligjshme, me anë të së cilës i merret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia.<sup>9</sup> Vrasja me qëllim mund ose nuk mund të ketë qenë e planifikuar paraprakisht, respektivisht e planifikuar dhe e dëshiruar paraprakisht me veprën e vrasjes. Megjithatë për vrasje si krim kundër njerëzimit, elementi mental kërkohet nëpërmjet të drejtës subjektive, ku mjafton që kryerësi ti paraqes viktimës lëndime serioze dhe të njëjtin ta privojë nga jeta. Kemi disa lloje të vrasjeve edhe atë: vrasje të rëndomtë, vrasje e kualifikuar, vrasjet nga motivet fisnike, vrasjet nga pakujdesia, vrasja e foshnjës gjatë lindjes, etj.

<sup>8</sup> Меѓународно кривично право, Антонио Касезе, Скопје 2009, стр. 109.

<sup>9</sup> E Drejta penale-pjesa e posaçme, Ismail Zejneli, Tetovë, 2007, faqe 19.

Vrasjet e kualifikuara janë lloji më i rëndë i vrasjeve për shkak se në këtë lloj vrasjeje personi privohet nga jeta në mënyrë të paramenduar, që me automatizëm edhe dënimi për këtë lloj vrasjeje është më i rëndë (prej 10 vjet deri në burgim të përjetshëm).

Vrasjet e kualifikuara ndër vete përbajnë lloje të ndryshme të interpretimit edhe atë:

- Vrasja në mënyrë mizore është ajo lloj vrasje ku personi tjetër privohet nga jeta me anë të vuajtjeve të mëdha fizike dhe psikike, gjatë së cilës edhe personi i cili e kryen vrasjen shpreh pëlqimin e tij që viktimës ti shkaktohen dhimbje dhe mundime të mëdha.
- Vrasja me qëllim të përfitimeve materiale, kjo lloj vrasje realizohet nga një person në personin tjetër me qëllim që të arrihet deri te të mirat materiale të viktimës të cilat do i marrë për vete apo për ndonjë person tjetër, ku kryerësi i kësaj vepre beson apo vetëm pre supozon se do të arrijë deri te përfitimi i tillë.
- Vrasja nga hakmarrja, kjo lloj vrasje daton qysh në kohët e lashta që nënkupton se zakonisht çon te gjakmarrja. Gjatë kryerjes së kësaj vepre zakonisht pësojnë persona të pafajshëm.
- Vrasja në mënyrë tinëzare, gjatë realizimit të kësaj vepre kryerësi vepron në mënyrë të fshehtë duke keqpërdorur dhe duke mashtruar viktimën, realizimi i së cilës bëhet në mënyrë direkte.
- Vrasja me qëllim të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, kjo lloj vrasje realizohet kur një person privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, respektivisht të ndalojë zbulimin e ndonjë vepre penale e cila është kryer kohë më parë.
- Vrasja e qëllimshme ku rrezikohen personat e tretë, vrasjet e tilla llogariten atëherë kur kryerësit për të realizuar qëllimin e vetë, vrasjen e ndonjë personi, venë në rrezik edhe persona të tretë të pafajshëm. Raste të tilla llogariten gjatë hedhjes së bombave dhe mjeteve tjera shpërthyes.
- Vrasja e gruas shtatzënë, kjo lloj vrasje ndryshe mund të quhet edhe si vrasje e dyfishtë për shkak se gjatë realizimit të kësaj vepre realizohet marrja e dy jetëve, të gruas shtatzënë dhe të jetës së ardhshme respektivisht foshnjës.
- Vrasja nga motivet e ulëta, motive të ulëta për tu realizuar kjo lloj vrasjeje llogariten kur kryerësin e mbisundon xhelozia, gjendja e vështirë sociale, etike apo morale.

- Vrasja në bazë të porosisë, kjo lloj vrasje ndryshe mund të llogaritet edhe si vrasje e organizuar pasi që për tu realizuar e njëjta duhet të ketë dy apo më tepër persona, dikush që porosit dhe dikush që realizon.

Vrasjet nga motivet fisnike llogariten e ato vrasje të cilat realizohen me qëllim që personit të sëmure apo të pashërueshëm i cili është duke vdekur dhe se është vërtetuar që nuk ka shpëtim, ti shkurtohen vuajtjet dhe të arrijë deri te vdekja në mënyrë më të shpejtë dhe pa dhimbje. Kjo lloj vrasjeje në të shumtën e rasteve realizohet edhe me kërkesë të vet viktimës. Vrasja nga pakujdesia, këto lloj vrasjesh llogariten si vrasje më të lehta për shkak të mënyrës me të cilën kryhet, ku privimi i personit tjetër vjen për shkak të pakujdesisë së kryerësit respektivisht kjo lloj vrasje nuk realizohet me dashje. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes llogaritet si vrasje e privilegjuar të cilën e kryen e ëma gjatë lindjes ose pas lindjes, për dallim prej vrasjes së lartpërmendur kjo lloj vrasje realizohet me dashje. Viktimë e këtij akti mund të jetë vetëm foshnja e posa lindur.

- *Zhdukja* – respektivisht vrasja masive si dhe imponimi i qëllimshëm i kushteve të jetës, ndalesa e ushqimit dhe ndihmës mjekësore, sjell deri te shkatërrimi i një pjese të popullatës. Gjykata Ndërkombëtare për krime në Ruandë, në disa raste e ka përcaktuar konceptin e zhdukjes, Gjykata Ndërkombëtare për krime në ish-Jugosllavi paraqiti një definicion më të mirë për rastin Krstić ku thuhet që krimi i zhdukjes të jetë kryer krahas kërkesave të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, ku duhet që patjetër të ekzistojë një dëshmi që një pjesë e popullatës ka qenë qëllim i krimit dhe anëtarët e saj kanë qenë të vrarë, duke llogaritur që kanë shkatërruar një numër të konsiderueshëm të popullatës civile. Gjykata Ndërkombëtare penale për krimet e kryera në ish-Jugosllavi për procedurën e shkallës së parë gjithashtu ka potencuar që në përputhje me rastin Tadić nuk është e nevojshme që viktimat të ishin të diskriminuar në baza politike, sociale apo edhe fetare. Thuhet se askush nuk mund të jetë i përjashtuar nga kjo formë e krimit e realizuar nga ana e një grupi terroristësh që për qëllim kanë përhapjen e terrorit, kuptohet, kusht i domosdoshëm që sulmi terrorist për zhdukjen e një pjese të popullatës duhet të paraqes një pjesë të sulmit sistematik.
- *Robërimi* – ky term është përpunuar në suaza të së drejtës subjektive, respektivisht nga ana e dy gjykatave ushtarake amerikane në *Nyrnberg*. Sipas Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare për krime i cili në mënyrë precize e përcakton idenë fillestare ku me robërim nënkuptohet realizimi i cilësdo forcë që ndërlidhet me të drejtën e pronësisë mbi persona dhe përmban realizim të asaj force duke kryer tregti me persona fizik

respektivisht me gra dhe fëmijë. Gjykata Ndërkombëtare për krimet e kryera në ish-Jugosllavi, në procedurën e shkallës së parë në disa raste bindshëm përmendën një grup elementesh që e shpjegojnë këtë definicion. Krahas kësaj kjo gjykatë në procedurën e shkallës së parë shumë qartë i shpjegon arsyet sipas së cilave vërtetohet që dy nga të akuzuarit janë fajtorë për veprën - robërim.

- *Deportimi ose shpërngulja e dhunshme e popullsisë* – respektivisht, paraqet dëbim me forcë të një pjese të popullsisë ose duke zbatuar një akt tjetër të dhunshëm nga sfera ku të njëjtat janë ligjrisht të pranishme, pa bazë juridike të lejuar nga e Drejta Ndërkombëtare. Nocioni i deportimit është shumë kompleks dhe përfshin veprimin me anë të së cilës një person i caktuar privohet nga liria duke u transferuar ose jo në drejtim të panjohur apo kur ndaj tij imponohet një pushtet i caktuar, kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.<sup>10</sup> Zyra për procedurën e shkallës së parë në Gjykatën Ndërkombëtare për krimet e kryera në ish-Jugosllavi për rastin Krstić ka vendosur që edhe ekzagjerimi edhe deportimi me dhunë zbatohen në mënyrë jo vullnetare dhe jo ligjore, d.m.th. deportimi i individëve nga territori në të cilin ata kanë qëndruar. Megjithatë këta dy terme nuk paraqesin sinonime në të Drejtën Ndërkombëtare. Dëbimi paraqet deportim nëpërmjet kufijve të shtetit, ndërsa deportimi i dhunshëm paraqet shpërngulje brenda kornizave të shtetit. Në rastin e lartpërmendur zyra për procedurë të shkallës së parë vërtetoi që në 12 dhe 13 Qershor të vitit 1995 rreth 25.000 boshnjakë muslimanë ishin të mbledhur me forcë jashtë nga Srebrenica në territorin që ishte nën kontroll të boshnjakëve musliman gjithmonë në korniza të të njëjtit shtet. Deportimi ishte i dhunshëm dhe ishte i realizuar për shkak të politikës së mirë organizuar që kishin për qëllim të dëbojnë popullsinë e boshnjakëve muslimanë nga Srebrenica. Zyra për procedurën e shkallës së parë erdhi në përfundim që këta persona të deportuar nga Srebrenica, nuk kanë qenë të dëbuar por të deportuar dhunshëm, që paraqet krime kundër njerëzimit.
- *Burgimi ose heqja e lirisë me dhunë* – Gjykata Ndërkombëtare Penale për krimet e ish-Jugosllavisë ishte gjykatë e parë ndërkombëtare që paraqiti një definicion mbi këtë krim. Kjo gjykatë mendonte se burgimi si krim kundër njerëzimit duhet të kuptohet si heqje e lirisë së një individi pa procedurën e duhur ligjore, por si pjesë e një sulmi sistematik drejtuar popullsisë civile.

---

<sup>10</sup> E Drejta penale-pjesa e posaçme, Ismail Zejneli, Tetovë, 2007, faqe 38.

- *Tortura* – Ndryshe mund ta llogaritim edhe si shkaktim i qëllimshëm i vuajtjes apo dhimbjes së madhe, në mënyrë fizike apo shpirtërore. Kushtetuta ndalon çdo formë të torturës, sjelljes dhe dënimit jo njerëzor dhe poshtërues, kjo vepër konsiderohet se është kryer me vetë faktin e përdorimit të dhunës, kanosjes apo mjetit tjetër të ndaluar me qëllim të nxjerrjes së dëshmisë apo të deklaratës.<sup>11</sup> Ky definicion në kuptimin e tij më të gjerë njihet qysh në konventën kundër torturës të vitit 1984. Kjo konventë mendonte se tortura si krim i ardhur nga një përlëshje e armatosur patjetër ndër vete ti përmbajë këto elemente: ajo përbëhet nga shkaktimi i një vuajtje ose dhimbje të madhe fizike apo shpirtërore; pas kësaj kjo vepër patjetër të jetë e qëllimshme; e njëjta patjetër të ketë për qëllim përfitimin e informatave, pranim, dënim, frikë, nënçmim kundër viktimës apo personit të tretë; e njëjta patjetër të jetë e ndërlidhur me një sulm të armatosur; së paku një prej personave të inkuadruar në procedurën e torturës patjetër të jetë person zyrtar publik de facto të jetë organ shtetëror. Zyra për procedurën e shkallës së parë gjithashtu inkuadroi edhe pjesë nga e Drejta Ndërkombëtare Humanitare që për ekzistimin e torturës patjetër të jetë i inkuadruar edhe nënçmimi i viktimës. Ky propozim u përkrah edhe nga marrëveshjet tjera të rëndësishme ndërkombëtare siç është edhe konventa e Gjenevës e cila për qëllim ka mbrojtjen e personave që nuk marrin pjesë në armiqësitë e dhunës kundër dinjitetit personal. Termi i nënçmimit është i lidhur ngushtë me termin e frikës që është renditur në definicionin e torturës në konventën kundër torturës. Më vonë Gjykata Ndërkombëtare Penale për krime të ish-Jugosllavisë e zgjeroi këtë definicion duke filluar nga rregulla se duhet të ketë një dallim ndërmjet definicionit të torturës sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës penale ndërkombëtare. Raste më të rënda të torturës ekzistojnë atëherë kur për marrjen e ndonjë dëshmie apo deklarate përdoren masa të cilat lënë pasoja të rënda për të akuzuarin.<sup>12</sup>
- *Dhuna gjinore* – kjo formë e krimeve ndër vete përmban *përdhunimin* (kategori e krimit që nuk ka qenë e definuar në të drejtën ndërkombëtare deri në themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare për krimet në Ruandë e cila paraqiti një definicion shumë të vogël mbi përdhunimin e më pas do të zgjerohet nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për krimet e ish-Jugosllavisë), *robërimi gjinor*, *prostitucioni i dhunshëm*, *shtatzania e dhunshme* (mbyllja jo ligjore e femrës dhe mbetja e saj shtatzënë në mënyrë të

<sup>11</sup> E Drejta penale-pjesa e posaçme, Ismail Zejneli, Tetovë, 2007, faqe 39.

<sup>12</sup> E Drejta penale-pjesa e posaçme, Ismail Zejneli, Tetovë, 2007, faqe 39.

dhunshme me qëllim që të ndikojë në përbërjen etnike të cilësdo përkatësie duke thyer rregullat e të drejtës ndërkombëtare).

- *Persekutimi* – i cilës do grup të caktuar për arsye politike, racore, nacionale, kulturore, fetare, gjinore, përgjithësisht e njohur si bazë e palejuar ligjrisht për diskriminim sipas të drejtës ndërkombëtare. Persekutimi nënkupton marrjen e rëndë me qëllim të të drejtave bazë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Gjykata Ndërkombëtare Penale për krimet e ish-Jugosllavisë propozoi një definicion më të detajuar në lidhje me këtë krim, ajo potencoi se të akuzuarit janë fajtorë për shkak të persekutimit për vrasje të qëllimshme dhe sistematike të personave në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjithashtu edhe mbajtja dhe dëbimi i organizuar i tyre mund të paraqes persekutim, kjo ndodh për shkak se këto lloj veprash radhiten si vrasje, burgim dhe persekutim të cilat janë të parapara në statutin e kësaj gjykate. Gjithashtu kjo gjykatë vërtetoi se edhe shkatërrimi dhe demolimi i shtëpive dhe patundshmërive të boshnjakëve musliman paraqet shkelje të të drejtave bazë të njeriut që gjithashtu paraqet persekutim.
- *Zhdukja e personave me dhunë* – paraqet burgim, mbajtje të personave me dhunë nga ana e ndonjë organizate politike të cilët kuptohet kanë lirinë e shtetit, që tu merret liria dhe të njëjtit të jenë të larguar nga mbrojtja ligjore për një periudhë të vazhduar kohore. Për ndalesën e zhdukjes së personave në mënyrë të dhunshme bazë ishin definicionet e ndryshme të dala nga statuti i gjykatës ndërkombëtare për krime, komisionit të brendshëm amerikan si dhe gjykatës për të drejtat e njeriut.
- *Krime tjera kundër njerëzimit me peshë dhe karakter të ngjashëm* – nënkuptohen të gjitha llojet e krimeve me anë të së cilëve shkaktohet vuajtje e madhe si dhe lëndime të rënda trupore, shpirtërore dhe fizike personave me qëllim. Ky term vjen nga statuti i Gjykatave të Nyrnbergut me anë të së cilës si krime thjesht i ndanë *krimet e tjera antinjerëzore* me një dispozitë që nuk kishte saktësi dhe nga këtu ishte në ndeshje me parimin e specificitetit, gjegjësisht në të drejtën mbi krimet. Sipas statutit të Gjykatës Ndërkombëtare për krime është formuluar kjo rregull me të cilën në shkallë të madhe kodifikohet dhe në shkallë të caktuar zhvillohet e drejta ndërkombëtare ekzistuese.

## KAPITULLI II

### KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT SIPAS GJYKATAVE NDERKOMBETARE PENALE

#### 2. 1 Gjykata Ndërkombëtare e Nyrembergut dhe Tokios

Shfaqjes së idesë për themelimin e gjykatës penale ndërkombëtare më së shumti i kanë kontribuar kryerja e krimeve të luftës, po ashtu aktet ndërkombëtare me të cilat janë përcaktuar rregullat e zhvillimit të luftës:

- *Deklarata e Parisit (1856)*
- *Konventa e Gjenevës për përmirësimin e pozitës së të plagosurve të luftës tokësore (1864)*
- *Deklarata e Petrogradit (1868)*
- *Deklarata e Brukselit (1874)*

Fillimi i një etape të re në avancimin e idesë për themelimin e një gjykate penale ndërkombëtare e përcaktojnë dy konferenca të Hagës të mbajtura në vitin 1899 dhe 1906. Kësaj ideje i kanë kontribuar edhe kur normat e së drejtës ndërkombëtare u konsoliduan dhe fituan karakterin supranacional. Akti i parë juridik-ndërkombëtar me të cilën u bënë përpjekje për themelimin e një gjykate penale ndërkombëtare është konferenca e paqes në Versajë e vitit 1919.<sup>13</sup>

Në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u bë edhe zhvillimi më i hovshëm në kuptim të plotë të së drejtës Penale Ndërkombëtare gjatë së cilës u bënë miliona njerëz viktimë e krimeve të ndryshme nga kriminelët nazist dhe aleatët e tyre. Këto viktima të luftës së dytë Botërore mblodhën vetëdijen e ndërkombëtarëve apo ndryshe thënë të forcave të mëdha aleate si SHBA-të, Franca, Anglia dhe Bashkimi sovjetik që të formojnë një institucion ku do të dënoheshin fajtorët e kësaj lufte. Vendi për arritjen e kësaj marrëveshje të forcave të mëdha u arrit në Londër me 8 Gusht të vitit 1945 për themelimin e një gjykatë ndërkombëtare ushtarake që për bazë do të kishte të gjykonte kriminelët e mëdhenj të Luftës së Dytë Botërore. Rezultat i kësaj marrëveshje ishte statuti i gjykatës Ndërkombëtare

---

<sup>13</sup> <https://www.slideshare.net/dritashala/e-drejta-penale-nderkombetare>

ushtarake e cila në bazë të disa shkencëtarëve ishte edhe pjesë kryesore për themelimin e kësaj gjykate. Veprat penale të parapara në statutin e gjykatës ndërkombëtare ushtarake duke u bazuar në nenin 6 të po të njëjtës ndahen në tri grupe:

- **Krimet kundër paqes** - Ushtrimi i luftës agresive, planifikimi apo përgatitja konsiderohen si krime kundër paqes me anë të së cilës bëhet shkelja e kontratave ndërkombëtare, marrëveshjeve apo pjesëmarrjes në ndonjë organizim të përbashkët për kryerjen e veprave të lartpërmendura.
- **Krimet e luftës** – shkelja e dokeve apo zakoneve të luftës si dhe shkelja e ligjeve të luftës konsiderohen si krime të luftës. Shkelje të këtilla konsiderohen plaçkitja e pasurisë publike apo private, shkatërrimi me qëllim i qyteteve, lagjeve apo fshatrave, vrasja apo keqtrajtimi i robërve të luftës, vrasja, dërgimi në punë të dhunshme e popullsisë civile në territoret e okupuara, etj.
- **Krimet kundër njerëzimit** – Vrasja, shfarosja, skllavërimi, deportimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë, burgosja ose privimi nga liria në kundërshtim me rregullat e të drejtës ndërkombëtare, tortura, zhdukja e detyruar e personave, dhunimi, skllavërimi seksual, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar, dhe vepra të tjera çnjerëzore të karakterit të ngjashëm që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha apo lëndime serioze të trupit konsiderohen si krime kundër njerëzimit.

Krahas veprave penale statuti i gjykatës ndërkombëtare Ushtarake parasheh edhe llojet e dënimeve të parapara për kryerësit e krimeve kundër paqes, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit edhe atë:

- Konfiskimi i pasurisë
- Kthimi i pasurisë së fituar në mënyrë kundërligjore
- Dënimi me vdekje
- Dënimi me burg të përjetshëm apo të përkohshëm
- Dënimi më gjobë dhe burgu me ose pa punë të dhunshme
- Marrja e disa apo të gjitha të drejtave qytetare

Me dispozitat e statutit të gjykatës ndërkombëtare ushtarake në veçanti u përcaktuan disa parime me të cilat u rregullua përgjegjësia penale për krimet e luftës, ndër parimet më kryesore janë:



- a. Udhëheqësit, organizatorët, shtytësit ose bashkëpunëtorët që kanë marrë pjesë në përpilimin ose ekzekutimin e ndonjë plani apo komploti me qëllim që të kryhet ndonjë krim i paraparë me statutin në fjalë, janë përgjegjës për të gjitha veprat që janë kryer në realizimin e atij plani (neni 6 al.3).
- b. Pozita zyrtare e kryerësit të veprës penale ndërkombëtare, qoftë kryetari i shtetit apo udhëheqës tjetër i lartë shtetëror apo ushtarak, sipas të drejtës Ndërkombëtare (neni 7) nuk mund të merret si rrethanë për përjashtimin e përgjegjësisë penale apo zbutjen e dënimit
- c. Fakti që kryerësi i veprës penale ndërkombëtare ka veprat sipas urdhrit të Qeverisë së tij ose të eprorit të tij, nuk do ta lirojë nga përgjegjësia penale, por kjo mund ti merret vetëm si rrethanë lehtësuese (neni 8)
- d. Me rastin e gjyqimit të cilitdo person të ndonjë grupi apo organizate, gjykata ka autorizime që grupin apo organizatën, anëtar i së cilës ka qenë kryerësi i veprës penale ndërkombëtare, ta shpall organizatë kriminale (neni 9). Në rastet e tilla çdo shtet që ka nënshkruar marrëveshjen ka të drejtë që për shkak të anëtarësimit në organizatat e përmendura, individët e këtillë ti nxjerr para gjykatës. Në të gjitha rastet e këtilla karakteri kriminal i grupit ose i organizatës konsiderohet si i provuar (i vërtetuar) nuk mund të mohohet (neni 10).<sup>14</sup>

Si kod i parë penal Ndërkombëtar me karakter të përkohshëm konsiderohet statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake duke u bazuar në përmbajtjen, natyrën dhe dimensionet e dispozitave të lartpërmendura.

Në bazë të marrëveshjes dhe Statutit të përmendur u formua Gjykata Ushtarake Në Nyrnberg, e cila në procesin që zgjati prej vitit 1945 deri në fund të vitit 1949 janë zhvilluar gjithsejtë 13 procese.<sup>15</sup> Në njërin prej proceseve të lartpërmendura të Gjykatës së Nyrnbergut janë gjykuar disa organizata naziste dhe 24 individë prej të cilëve 12 kriminel luftime të cilët u dënuan me vdekje, 4 persona dënim me burg prej 10 deri 20 vjet, 3 persona me burg të përjetshëm dhe 3 personat tjerë u liruan nga akuza. Në proceset e mëvonshme numri më i madh i të gjykuarve kanë qenë zyrtar të aparatit shtetëror të Gjermanisë. Gjithsejtë në të gjitha proceset e zhvilluara në gjykatën Penale Ndërkombëtare të Nyrembergut janë shqiptuar 36 dënime me vdekje, 4 dënime më burgim prej 10 deri 20 vjet, 23 dënime me burgim të përjetshëm dhe 3 persona që janë liruar nga akuza.

<sup>14</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 276

<sup>15</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 277

Aleatët kanë krijuar gjykata ushtarake në zonat e tyre, këto gjykata, gjatë dhe pas procesit të Njrembergut kishin gjykuar disa mijëra gjerman. Prej tyre SHBA-të ishin gjykuar 1,814 persona prej të cilëve 450 janë ekzekutuar, Britania e Madhe kishte gjykuar 1,085 prej të cilëve 240 janë ekzekutuar, Franca kishte gjykuar 2,107 prej të cilëve 109 janë ekzekutuar, kurse BRSS-ja besohet se kishte gjykuar 10,000 persona por nuk ka të dhëna sa ishin ekzekutuar. Përveç këtyre janë ndjekur nga SHBA-te 809 persona, nga Britania e Madhe 524 persona, Australia 256 persona, Franca 254 persona, Holanda 30 persona, Polonia 24 persona, Norvegjia 9 persona etj.<sup>16</sup>

Një vit me vonë, me 15 Janar të vitit 1946 krahas gjykatës penale ndërkombëtare ushtarake në Njrmnberg u themelua edhe gjykata penale ndërkombëtare ushtarake në Japoni apo më saktësisht në Tokio në të cilën u gjykuan po ashtu kriminelët kryesor japonez të dalë nga Lufta e Dytë Botërore. Gati të gjitha parimet në bazë të së cilave u zhvilluan të gjitha procedurat penale në këtë gjykatë ku edhe u dënuan fajtorët kryesorë ishin të ngjashme apo identike me të gjitha parimet e gjykatës së Njrembergut. Në këtë gjykatë është zhvilluar procedurë penale ndaj 28 të akuzuarve prej të cilëve 16 persona janë dënuar me burgim të përjetshëm, 2 persona janë dënuar me burgim, 7 persona janë dënuar me vdekje ndërsa ndaj 3 personave është ndërprerë procedura penale. Duke u bazuar në faktin se numri i të akuzuarve dhe numri i kriminelëve të dënuar në të dy gjykatat e lartpërmendura ishte tejet simbolik prapë se prapë paraqet një hap të rëndësishëm në historinë e njerëzimit e në veçanti në historinë e te drejtës penale ndërkombëtare. Jo rastësisht përmendëm se numri i të akuzuarve dhe numri i kriminelëve të dënuar ishte simbolik pasi që vetëm në Evropë në listë kanë qenë rreth 20 mijë të akuzuar për krime të Luftës së Dytë Botërore ndërsa në Japoni rreth 5 mijë. Vlen të theksohet se duke u bazuar në parimet e statutit të këtyre gjykatave veprat e kriminelëve fashist nuk kanë qenë të parapara si vepra penale duke u bazuar në legjislacionet penale te asokohe që ishin në fuqi në shtetet e tyre.

Këto parime ishin shumë të vlefshme asokohe saqë edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara formuloi një rezolutë te posaçme i verifikoi të njëjtat dhe i vendosi si parime themelore të drejtës ndërkombëtare pozitive. Gjithashtu këto parime Kombet e Bashkuara i morën si bazë për kodifikimin e të drejtës ndërkombëtare që për detyrë do të kishte të përgatiste një projekt të krimeve kundër njerëzimit, më vonë në vitin 1946 Asambleja e Kombeve të Bashkuara me anë të një rezolute të veçantë projektin e

---

<sup>16</sup> "E Drejta Ndërkombëtare Publike", Zejnullah Gruda, Shkup 2007, faqe 152.

lartpërmendur do t'ia ngarkojë Komisionit për Kodifikimin e së Drejtës Ndërkombëtare. Ndër vendimet e rëndësishme të cilat janë miratuar nga Kombet e Bashkuar është edhe detyrimi i shteteve që të përjashtojnë parashkrimin nga ligjet e veta për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Nuk ka dyshim se gjykimi në Nyrnberg e në Tokio dhe parimet e Nyrnbergut shënojnë një hap të rëndësishëm në zhvillimin e së Drejtës Ndërkombëtare Penale, megjithëse nuk garantojnë paqe.<sup>17</sup> Ky komision pranoi detyrën dhe mori përsipër që të analizojë apo shqyrtojë edhe mundësinë për të themeluar një gjykatë të veçantë Penale Ndërkombëtare, mirëpo edhe sot e kësaj dite përkundër përpjekjeve të këtij komisioni nuk është arritur që të përgatitet një kodeks i veçantë i krimeve kundër njerëzimit dhe sigurisë së njerëzimit.

## **2. 2. Gjykata Ndërkombëtare e Hagës**

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe gjykimit të kriminelëve problemi i përgjegjësisë penale nuk përfundoi. Me ndryshimin e mentalitetit njerëzor filloi të del në dukje edhe fryma e demokratizimit të shteteve të Evropës që filloi nga viti 1970 e që më konkretisht do të fillonte me rrënimin e Murit të Berlinit të vitit 1989 gjë që do të mundësonte bashkimin e Gjermanisë e cila deri në këtë kohë ishte e ndarë në dy shtete, e njëjta frymë vazhdoi edhe në shtetet e Evropës Lindore ku vlen të përmendet edhe Bashkimi Sovjetik, Jugosllavinë dhe Shqipëria. Kjo frymë demokratike u kundërshtua ashpër nga regjimi serb të cilët përdorën forcën policore dhe mekanizma të ndryshëm që të rrënojnë në tërësi autonominë e Kosovës duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 ku edhe vranë disa dhjetëra demonstrues shqiptarë e disa dhjetëra të tjerë i plagosën vetëm për shkak se të njëjtat demonstrata që ishin kryesisht të qeta ishin në kundërshtim me aktet e regjimit serb. Duke u bazuar në këtë vepër regjimi serb do t'ua mohojë të drejtën e vetëvendosjes edhe shteteve tjera pjesëtare të ish Republikës Federale të Jugosllavisë që të ndahen nga kjo krijesë artificiale dhe të krijoheshin si shtete të pavarura. Respektimi i akteve të veta do të shtynte regjimin serb që të shfrytëzojë të gjithë armatimin kundër shteteve përkatëse të ish Jugosllavisë dhe të zhvillojë luftëra makabre në Bosnje Hercegovinë dhe Kroaci për plot 5 vjet duke filluar nga viti 1991 deri në vitin 1995., e njëjta procedurë do të zhvillohej edhe në Slloveni ku lufta nuk zgjati më shumë se 40 ditë ndërsa në Maqedoni ishte pak më ndryshe ku ushtria jugosllave u tërhoq pa luftë.

---

<sup>17</sup> "E Drejta Ndërkombëtare Publike", Zejnullah Gruda, Shkup 2007, faqe 154.

Lufta e zhvilluar në territorin e Bosnjë Hercegovinës dhe Kroacisë nga armata serbe do të bënte bujë në krejt botën dhe llogaritet si luftë ku janë kryer krime nga me të rëndat dhe të papara që pas Luftës Dytë Botërore e këndej, vetëm në Bosnje Hercegovinë llogaritet se janë vrare diku rreth 250,000 njerëz shumica e të cilëve popullsi civile (gra, fëmijë, pleq) të cilët mendohet se kanë qenë të përkatësisë fetare myslimane, krime të cilat gjithsesi kanë qenë kundër konventave ndërkombëtare. Në këtë luftë janë kryer edhe shumë krime kundër njerëzimit që do të detyronte shumë njerëz të shpërngulen nga shtëpitë dhe trojet e tyre që më vonë do të emërohej edhe si pastrim etnik. Krime të tjera të rënda që kanë ndodhur gjatë zhvillimit të këtyre luftërave kanë qenë vrasjet e qëllimshme, vrasjet në masë, torturimi, dhunimet, plaçkitjet, shkatërrimi i të mirave private, zhdukja e objekteve kulturore dhe fetare, etj.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e aprovoi rekomandimin e sekretariatit të Përgjithshëm dhe me rezolutën numër 827 me datë 22 Shkurt 1993 e themeloi Gjykatën Penale Ndërkombëtare në Hagë për gjykimin e personave për krimet e luftës që u kryen në territorin e Jugosllavisë së mëparshme. Emërtimi i tërësishëm i kësaj gjykate është: Tribunali Ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë duke filluar prej vitit 1991. Shkurtimisht kjo gjykatë në literaturë dhe në fjalorin e përditshëm njihet si Tribunali i Hagës.<sup>18</sup>

Lënja në harresë e kriminelëve të cilët kanë kryer krime shumë të rënda gjatë kohës së luftërave dhe mos dënimit të tyre u erdhi fundi me themelimin e Tribunalit të Hagës. Themelimi i po të njëjtës llogaritet si një e arritur shumë e madhe apo ndryshe thënë edhe si një revolucion si në historinë e njerëzimit ashtu edhe në të drejtën penale ndërkombëtare. Pas themelimit të gjykatës penale ndërkombëtare të Nyrnbergut dhe Tokios gjegjësisht pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore për herë të parë pas diku afër 50 viteve themelohet një gjykatë penale ndërkombëtare e cila do të shërbente për gjykimin e kriminelëve të cilët kanë kryer krime makabre gjatë luftërave në territorin e ish Jugosllavisë. Vlen të theksohet se edhe gjykatat e Nyrnbergut dhe Tokios edhe Tribunali i Hagës, janë gjykata të stilit AD-HOC që do të thotë se kjo e fundit është themeluar vetëm për të gjykuar krimet të cilët janë kryer në territorin e ish Jugosllavisë, pas përfundimit të të njëjtave kjo gjykatë do të pushojë së vepruari. Dallimi ndërmjet themelimit të Tribunalit të Hagës dhe gjykatës së Nyrnbergut

---

<sup>18</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 280

dhe Tokios qëndron në faktin që se Tribunali i Hagës u themelua nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ku anëtare janë pjesa më e madhe të shteteve të të gjithë botës, ndërsa gjykatat e Nyrnbergut dhe Tokios u themeluan nga disa fuqi të mëdha (Anglia, SHBA, Franca dhe Bashkimi Sovjetik). Dallim tjetër që vlen të theksohet është se në Tribunalin e Hagës gjykohen të gjitha krimet e kryera pavarësisht shteteve përkatëse ndërsa në gjykatën Penalë Ndërkombëtare në Nyrnberg dhe Tokio u gjykuan vetëm fajtorët e shteteve të cilët e humbën luftën.

### **2. 2. 1. Vendimi Tribunalit të Hagës për të kryer hetime edhe në Kosovë**

Krimet e regjimit serb të kryera ndaj popullit të pafajshëm civil të Kosovës zgjati disa vite edhe atë qysh me themelimin e kushtetutës së parë të Kosovës të vitit 1974 e rrënoi autonominë e Kosovës në vitin 1989 ku edhe vrau dhjetëra demonstrant të pafajshëm shqiptarë, dhjetëra të tjerë i burgosi. Prej këtij viti e deri në fillimin e luftës regjimi serb kryente gjeste të pa lakmueshme ndaj popullit të Kosovës me të vetmin qëllim që ta shuajë aspiratën e shqiptarëve për fitimin e lirisë dhe pavarësisë, gjatë këtyre viteve shumë shqiptarë u vranë me mijëra janë keqtrajtuar psikikisht dhe fizikisht, janë dëbuar nga puna rreth 120,000 punëtorë, ka ndaluar botimin e gazetës Rilindja që ishte edhe gazetë e vetme ditore gjithashtu mbylli edhe radiotelevizionin në gjuhën shqipe, etj.

Duke u bazuar në vendimin kategorik të regjimit serb që pavarësinë e Kosovës ta fitojnë me mjete paqësore dhe duke parë mos gatishmërinë e faktorit ndërkombëtar që të ndërhyjnë në veprimet e regjimit serb të cilat thyen të gjithat konventat ndërkombëtare, lindi edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës nga vetë populli i Kosovës ku në fund të vitit 1998 kjo ushtri filloi edhe veprimtarinë e saj për mbrojtjen dhe çlirimin e popullit shqiptar të Kosovës nga regjimi serb. Ky gjest aspak nuk u prit mirë nga Serbia e cila në kundërshtim me elementet themelore të konventës së Hagës dhe Gjenevës ndërmori aksione të mëdha luftarake duke shfrytëzuar armatim të rëndë nga forcat policore dhe ushtarake. Periudha më brutale e kësaj lufte ka qenë diku mesi i vitit 1999 ku edhe intervenuan forcat e NATO-s të udhëhequra nga SHBA-të me të vetmin qëllim të ndërpriten masakrat dhe krimet e rënda kundër njerëzimit të kryera ndaj popullit të Kosovës. Gjatë vitit 1998 dhe 1999 forcat policore dhe ushtarake serbe vranë diku rreth 13,000 shqiptarë prej të cilëve shumica ishin pjesëtarë të popullsisë civile, u rrëmbyen rreth 3,700 shqiptarë, u shkatërruan dhe u dogjën rreth 200,000 shtëpi.

Për krejt këto krime të kryera nga regjimi serb ndaj popullsisë së Kosovës Tribunali i Hagës i konsideron si krime kundër të drejtës Ndërkombëtare dhe për herë të parë në vitin 1999 ngriti akuzë kundër kryetarit të ish-Jugosllavisë Slobodan Millosheviqit, edhe ndaj kryetarit të Serbisë Milutinoviqit dhe disa bashkëpunëtorë të tij. Proceduar e gjykimit të Slobodan Millosheviqit zgjati diku 7 muaj ku dëshmuan rreth 120 dëshmitarë. Vlen të theksohet se për herë të parë në Tribunalin e Hagës është dënuar gjenerali serb Radosllav Kërstiq për kryerjen e gjenocidit ku u vranë rreth 8,000 boshnjak në Srebrenicë.

### **2. 2. 2. Statuti i Tribunalit të Hagës**

Statuti i Tribunalit të Hagës është i autorizuar të gjykojë kriminelët të cilët janë përgjegjës për shkeljet e rënda të Drejtës Penale Ndërkombëtare të kryera në territorin e ish Republikës Federale të Jugosllavisë duke filluar nga viti 1991, ky statut është aprovuar nga Këshilli i Sigurimit në vitin 1993 ku rregullat e procedurës i nxjerr vetë kjo gjykatë.

Në nenet 2-5 të statutit të Tribunalit më për së afërmi janë përcaktuar llojet e krimeve për të cilat gjykata është kompetente të gjykojë kriminelët e luftës. Këto lloje të krimeve janë: shkeljet e rënda të konventave të Gjenevës të vitit 1949, shkeljet e së drejtës së luftës apo zakoneve të luftës, gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit.<sup>19</sup>

Tortura, vrasja me qëllim, eksperimentet biologjike, lëndimet e rënda trupore, privimi i robërve të luftës, depërtimi apo transportimi i kundërligjshëm i civilëve, marrja peng e civilëve, të gjitha këto lloje të krimeve konsiderohen si shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949. Shkatërrimet dhe rrënimet e vendeve, qyteteve dhe fshatrave, përdorimi i helmeve dhe armëve me qëllim të shkaktimit të vuajtjeve, sulmi dhe bombardimi i qyteteve dhe fshatrave, rrënimi dhe dëmtimi me qëllim i institucioneve të religjionit, plaçkitja e pasurisë publike apo private, të gjitha këto lloje të krimeve llogariten apo konsiderohen si shkelje të së drejtës së luftës. Transferimi me dhunë i fëmijëve të njërit grup në grupin tjetër, vrasja e anëtarit të grupit, shfarosja e plotë apo e pjesërishtme fizike e grupit, shkaktimi i lëndimeve të rënda psikike apo fizike të anëtarëve të grupit, të gjitha këto lloje të krimeve llogariten si gjenocid. Shfarosja, tortura, mbyllja, zënia rob, vrasja, depërtimi, marrëdhënia seksuale me dhunë dhe veprime tjera jo njerëzore konsiderohen si krime kundër njerëzimit.

---

<sup>19</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 284

Në nenin 8 të statutit të Tribunalit të Hagës është përcaktuar edhe kompetenca territoriale dhe kohore që do të vlejë për gjithë territorin e ish republikës Federale të Jugosllavisë që ndër vete përfshin hapësirën tokësore, hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale, kurse kompetenca tjetër kohore përfshin periudhën kohore duke filluar nga viti 1991.

I vetmi dënim që mund të shqiptohet kriminelëve të dalë nga lufta duke u bazuar në Statutin e Tribunalit të Hagës është dënimi me burgim i cili mund të realizohet për një kohë të caktuar dhe burgim të përjetshëm, gjë që na tregon qartë se ky Statut nuk parasheh shqiptimin e dënimit me vdekje. Përveç dënimit me burgim gjykata mund të jap urdhër që kriminelëve tu merret pasuria dhe të gjitha fitimet e realizuara nga veprat kriminale. Tribunali i Hagës është ai i cili cakton se në cilin shtet do të ekzekutohet dënimi me burgim.

Tribunali i Hagës gjatë periudhës disa vjeçare së ekzistuari, ka rezultuar me një numër kryesisht të vogël të gjykimeve për krimet e kryera në Kroaci, Bosnjë Hercegovinë dhe Kosovë, mirëpo në anën tjetër mosgatishmëria e shteteve sidomos e Serbisë ka vështirësuar punën e kësaj gjykate duke mos dorëzuar fajtorët për krimet, domethënë Serbia as nuk i dorëzon kriminelët e luftës por as nuk i dënon në gjykatat e veta. Është përvoja e deritanishme dhe themelimi i Tribunalit të Hagës që nxiti një ide të shumëpritur për të themeluar një gjykatë penale ndërkombëtare të përhershme.

### **2. 3. Gjykata Penale Ndërkombëtare në Ruandë dhe Sierra Leone**

Në vitin 1994 duke marrë parasysh masakrat e gjera dhe sistematike si dhe vrasjet e civilëve, zhvendosjen dhe eksodin masiv të refugjatëve në vendet fqinje, Këshilli i Sigurimit krijoi një tjetër Gjykatë Penale Ndërkombëtare të stilit ad-hoc këtë herë në Ruandë.<sup>20</sup> Kjo gjykatë e ngjashme me Tribunalin e Hagës është themeluar në Ruandë më 8 Shtator të vitit 1994. Edhe kjo gjykatë është themeluar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me rezolutën numër 955 dhe ka për detyrë që të konstatojë përgjegjësinë penale dhe ti dënojë fajtorët e pjesëtarëve të fisit Tutsi për vepra penale të kryera kundër njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare në Ruandë, të cilët vetëm brenda një viti kalendarik (vitin 1994) vranë dhe masakruan rreth 800,000 pjesëtarë të fisit Tutsi.<sup>21</sup> Ruanda duke qenë anëtare e OKB-së në fillim e përkrahi themelimin e këtij tribunali por më vonë e kundërshtoi atë. Sipas statutit të këtij tribunali kjo gjykatë ka kompetencë për krimet kundër njerëzimit, gjenocidit, dhe

---

<sup>20</sup> Media dhe gjenocidi i Ruandës, Allen Tompson, 2007, faqe 28.

<sup>21</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 289

shkelje të Nenit 3 të protokollit shtesë të konventës së Gjenevës<sup>22</sup>, të kryera në territorin e Ruandës për një periudhë një vjeçare. Sipas këtij Statuti krime kundër njerëzimit përbënin këto lloje aktesh: shfarosja, depërtimi me dhunë, vrasja, zhdukja, burgosja, përdhunimi, tortura, si dhe veprat të tjera antinjerëzore.<sup>23</sup> Sipas Nenit 6 të këtij Statuti do të jetë penalisht përgjegjës kushdo që ka ndihmuar, planifikuar, nxitur, përgatitur dhe ekzekutuar qoftë ky edhe person me detyra shtetërore, subjekti që ky nen mbron është popullsia civile me baza kombëtare, politike, etnike, racore dhe fetare.<sup>24</sup>

Pas një luftë civile të shkaktuar nga një grup rebel, pas vitit 1991, i njohur si fronti i bashkuar Revolucionar që hyri nga Liberia fqinje në Sierra Leone për të përmbysur regjimin egzistent në Sierra Leone. Ky konflikt vazhdoi edhe pas vitit 1996 ndërmjet qeverisë së re të sapo zgjedhur demokratike dhe forcave mbrojtëse civile kundër frontit të bashkuar revolucionar e më pas edhe kundër Këshillit Revolucionar të forcave të armatosura dhe Frontit të Bashkuar Revolucionar. Ky konflikt njihet nga dhuna masive e ndër vete përmban të gjitha format e ndryshme të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, përdhunimin masiv dhe rrëmbimin e grave, duke përdorur edhe fëmijët si ushtar si dhe dëmtimin e gjymtyrëve të civilëve. Kryesuesit e frontit të bashkuar revolucionar diku në vitin 2000 u arrestuan me akuze se kanë kryer sulme të rënda ndaj popullsisë së pafajshme civile dhe forcave qeveritare. Në po të njëjtin vit presidenti i atëhershëm i Sierra Leones formuloi një plan ku do të kërkohej nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që të themelohej një tribunal që do të ishte apostafat për krimet e kryera në Sierra Leone.<sup>25</sup> Këshilli i Sigurimit pranoi kërkesën e presidentit të Sierra Leones dhe si përgjigje miratoi rezolutën 1315 duke kërkuar që Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara të fillojë bisedimet me Sierra Leonen për të themeluar një gjykatë të posaçme dhe të pavarur. Këto bisedime midis Qeverisë së Sierra Leones dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së rezultoi pozitiv dhe u arrit një marrëveshje me datën 16 Janar të vitit 2002.<sup>26</sup> Për dallim nga gjykatat tjera kjo gjykatë nuk u krijua nga një rezolutë e dalë nga Këshilli i Përgjithshëm i Sigurimit, por u themelua nga një marrëveshje midis Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë së atëhershme në Sierra Leone, për këtë arsye llogaritet si një institucion i veçantë ndërkombëtar dhe jo si organ ndihmës i Këshillit të Sigurimit. Duke u bazuar në

---

<sup>22</sup> Neni 2, 3, 4 i Statutit të Tribunalit të Ruandës.

<sup>23</sup> Neni 3 i Statutit të Ruandës.

<sup>24</sup> Neni 3 i Statutit të Ruandës

<sup>25</sup> Praktika Penale Ndërkombëtare, Steven Powels, John R. W. D. Jones, 2003, faqe 18.

<sup>26</sup> Praktika Penale Ndërkombëtare, Steven Powels, John R. W. D. Jones, 2003, faqe 18.



legjislacionin e Qeverisë së Sierra Leones, kjo gjykatë nuk llogaritet si pjesë e këtij legjislacioni, shumica e gjykatësve janë gjykatës ndërkombëtar të emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe pjesa më e vogël emërohen nga vetë Qeveria e Sierra Leones, prokurorin dhe sekretarin gjithashtu i emëron OKB-ja ndërsa Qeveria e Sierra Leones emëron vetëm një zëvendës prokuror.<sup>27</sup>

Sipas Nenit 2 të Statutit të Gjykatës së Sierra Leones, si krime kundër njerëzimit llogariten: shfarosja, dëbimi, vrasja, tortura, burgimi, skllavërimi, përdhunimi dhe akte të tjera antinjerëzore. Të gjitha këto veprime llogariten si pjesë të një sulmi të përhapur ndaj çdo popullsie të pafajshme civile. Vlen të theksohet se kjo gjykatë nuk ka juridiksion mbi gjenocidin, juridiksioni i kësaj gjykate ndër vete përmban edhe disa shkelje tjera të rënda kundër ligjeve ndërkombëtare humanitare për shembull: regjistrimi i fëmijëve në forcat e armatosura, shkeljet që kanë të bëjnë me abuzimin e vajzave dhe shkatërrimin e pronës.

#### **2. 4. Gjykata e përhershme Penale Ndërkombëtare**

Plani për themelimin e një gjykatë të përhershme penale ndërkombëtare ekziston qysh në kohët e lashta edhe atë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe luftërat tjera duke e përfshirë edhe atë të zhvilluar në territorin e ish-Jugosllavisë. Forcat e mëdha botërore arritën një revolucion historik për sa i përket të drejtës ndërkombëtare penale ku themeluan gjykatën ndërkombëtare penale në Nyrnberg, Tokio, Tribunalin e Hagës dhe Gjykatën e Ruandës të cilat ishin të stilit ad-hoc. Edhe gjatë themelimit të gjykatave të lartpërmendura edhe gjatë funksionimit të tyre ideja e forcave të mëdha botërore dhe shteteve anëtare të OKB-së ishin që të themelojnë një gjykatë të përhershme penale ndërkombëtare.

Me 17 Korrik të vitit 1998 në konferencën e organizatës së kombeve të bashkuara të mbajtur në Romë, në të cilën morën pjesë delegatët e 160 shteteve me shumicën absolute për herë të parë në historinë e njerëzimit u nënshkrua marrëveshja për themelimin e gjykatës së përhershme ndërkombëtare, selia e së cilës u vendos të jetë në Hagë.<sup>28</sup> Duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në Romë kjo gjykatë mbi supet e saj do të ketë kompetencat për të gjykuar krimet e gjenocidit, krimet e luftës dhe në përgjithësi krimet kundër njerëzimit, procedurat e të cilave do të udhëhiqen nga 18 gjykatës, ku secili shtet duhet të japë leje për

<sup>27</sup> Neni 12-16 i Statutit të Gjykatës në Sierra Leone

<sup>28</sup> "E drejta penale ndërkombëtare", dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2005, faqe 290

nisjen e procedurës të të akuzuarit të vet. Në vitin 2003 u bë përzgjedhja e 18 gjykatësve ku secili prej tyre bëri betimin për gjykim të drejtë, gjykatësit e zgjedhur ishin nga vende të ndryshme të botës ku 7 prej tyre ishin femra. Vlen të theksohet se gjatë këtij solemniteti prezent ishte edhe sekretari i përgjithshëm i OKB-së së asaj kohe zotëri Kofi Anan, i cili theksoi se kjo ditë duhet të llogaritet si historike për drejtësinë e mbarë njerëzimit sepse deri më sot kishin ekzistuar vetëm gjykata ad-hoc me autorizime të kufizuara. Me fjalë të tjera kjo gjykatë llogaritet edhe si gur themeli i të drejtës ndërkombëtare penale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e cila do të funksionojë dhe do të jetë në mbrojtje të çdo qytetari individualisht dhe mbarë njerëzimit.

#### **2. 4. 1. Statuti i gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare**

Ekspertët më të mëdhenj në botë të së drejtës penale dhe të drejtës ndërkombëtare filluan të përgatitin edhe statutin e gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare që llogaritet edhe si themel i gjykatës, të cilën e ndërtauan duke u bazuar në statutin e gjykatave të Nyrnbergut dhe Tokios, Tribunalit të Hagës dhe Konventave të Gjenevës të vitit 1949. Kompetenca kryesore e kësaj gjykate është të gjykojë kriminelët që kanë kryer krimet më të rënda penale ndërkombëtare të bazuara në statutin e saj i cili është i përbërë prej 128 neneve me anë të së cilëve rregullohen këto çështje: themelimi i gjykatës, kompetencat e gjykatës, gjykimi, dënimet, ekzekutimi i dënimeve, financimi i gjykatës, administrimi i gjykatës, hetimi dhe prokuroria dhe dispozitat përfundimtare. Parimi themelor i kësaj gjykate është *nullum crimen sine lege*, ku edhe kompetenca e gjykatës kufizohet duke gjykuar vetëm personat e akuzuar për krime të rënda të cilët janë të paraparë me të drejtën ndërkombëtare.

#### **2. 4. 2. Veprat penale që janë kompetencë e kësaj gjykate**

Për dallim nga statutet e gjykatave tjera, ku ishin paraparë tre grupe të veprave penale ndërkombëtare në nenin 5 të statutit të gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare janë paraparë katër grupe të veprave penale ndërkombëtare edhe atë: gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe si risi janë paraparë edhe krimet e agresionit.

- Gjenocidi – llogaritet si lloj më i rëndë i të gjitha veprave penale kundër njerëzimit, fjala gjenocid rrjedh prej fjalës greke *genos* që do të thotë *racë* apo *gjini*, dhe fjalës *ocidere* që do të thotë *për të vvarë* apo *për të zhdukur*. Si krime të gjenocidit llogariten vrasja e anëtarit të grupit, shfarosja e plotë apo e pjesërishtme fizike e qëllimshme e

grupit, transferimi me dhunë i fëmijëve nga një grup në grupin tjetër, pengimi i lindjeve brenda grupit dhe shkaktimi i lëndimeve psikike të anëtarëve të grupit.

- Krimet kundër njerëzimit – për dallim nga veprat tjera penale ndërkombëtare krimet kundër njerëzimit ndër vete përmbajnë lloje të ndryshme të veprave penale kundër popullsisë civile. Si krime kundër njerëzimit llogariten skllavërimi, transferimi i dhunshëm i popullsisë, tortura, vrasja, shfarosja, prostitucioni i detyruar, shtatzënia me dhunë, zhdukja e detyruar e personave, dhe vepra tjera të ngjashme antinjerëzore që kanë të bëjnë me lëndime serioze të trupit apo të shëndetit të njeriut.
- Krimet e luftës – bazën e tyre juridike e ndajnë në dy pjesë, pjesa e parë bazohet në krimet e luftës që parashihen në konventat e Gjenevës të vitit 1949 ndërsa pjesa tjetër ku bëhet shkelja e rëndë e ligjeve të cilat janë të parapara për konfliktet ndërkombëtare. Krimet e luftës të bazuara në konventat e Gjenevës janë: tortura, eksperimentet biologjike, marrja e pengjeve dhe vrasjet e qëllimshme. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë: sulmet në objektet civile, bombardimet e fshatrave, qyteteve dhe objekteve me karakter fetar, sulmet me dashje në vendet ku banojnë njerëz, përdorimi i armëve të ndaluara, etj.
- Krimet e agresionit – për këto lloj krimesh ende nuk ekziston ndonjë përkufizim adekuat që në mënyrë më të detajuar do të kishte përshkruar të gjitha këto lloje të krimeve. Gjykata e përhershme penale ndërkombëtare për krimet e agresionit do të ushtrojë juridiksionin e vetë që është në përputhshmëri me dispozitat e paktit të OKB-së.

#### **2. 4. 3. Dënimi dhe ekzekutimi i tyre**

Duke u bazuar në statutin e gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare përveç parimeve të përgjithshme të së drejtës penale janë paraparë edhe dënimet dhe ekzekutimi i tyre që janë të domosdoshme për kryerësit e veprave të ndryshme penale. Vlen të theksohet se gjatë përpilimit të statutit të kësaj gjykate ka pasur mendime të ndryshme për shqyrtimin e sanksionit më të rëndë të kryerjes së veprës penale për krimet më të rënda siç është dënimi me vdekje, mirëpo një gjë e tillë nuk u arrit dhe statuti aktual i kësaj gjykate nuk e parasheh dënimin me vdekje. Statuti i kësaj gjykate i parasheh këto lloje të dënimeve:

- Dënimi me gjobë, është dënim i cili nuk llogaritet si primar por njihet si dënim plotësues dhe shqiptohet duke u bazuar në provat dhe kriteret të cilat i përcakton dhe rregullon vet gjykata;
- Dënimi me burgim deri në 30 vjet, ky lloj dënimi shqiptohet në afat prej disa vitesh mirëpo nuk duhet të kalojë kohëzgjatjen prej 30 vjet. Së bashku me këtë lloj dënimi është paraparë edhe masa e konfiskimit të pasurisë e cila nuk konsiderohet si dënim, por një lloj ndëshkimi që shtyn në konfiskimin e pasurisë në mënyrë direkte apo indirekte të fituar gjatë realizimit të veprës penale, dhe
- Dënimi me burgim të përjetshëm, është dënim që shqiptohet për kryerësit e veprave të rënda penale.

Sipas dispozitave të statutit të kësaj gjykate, ekzekutimi i dënimeve me burgim shqiptohet nëpër burgjet e shteteve që paraprakisht kanë ratifikuar marrëveshjen e nënshkruar në Romë që me automatizëm nënkupton se të njëjtat shtete kanë dhënë edhe lejen e tyre që do ti pranojnë kriminelët e dënuar, mirëpo se në cilin shtet kriminelin do të vuaj dënimin atë e vendos vetë gjykata. Në rastet e jashtëzakonshme kur gjykata nuk mund të vendos se në cilin shtet të vuhet dënimi me burgim atëherë i njëjti burgim ekzekutohet në Holandë respektivisht në burgjet e Holandës. Masat që ndërmerren për konfiskimin e pasurisë gjithashtu ekzekutohen në atë shtet të cilin e ka caktuar vetë gjykata, ajo pasuri e tërë e konfiskuar i shkon fondit të gjykatës ku më pas u dedikohet viktimave të dala nga vepra penale dhe familjarëve të tyre. Përpos shqyrtimit të dënimeve të lartpërmendura, gjykata mund edhe të zbusë dënimin në rastet kur personi i dënuar ka vuajtur dy të tretat e dënimin, në rastet kur personi ka vuajtur 25 vjet të dënimin gjykata mund t'ia zbusë dënimin vetëm në rastet kur dënimi është me burgim të përjetshëm.

#### **2. 4. 4. Struktura dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i gjykatës**

Përpos elementeve të lartpërmendura që janë pjesë përbërëse e gjykatës vlen të përshtrehet edhe struktura që ndryshe mund ta quajmë edhe si skeleti i gjykatës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Më lartë e kemi përmendur se në gjykatë janë të emëruar 18 gjykatës mirëpo nuk e kemi përmendur se mandati i tyre është i paraparë 9 vjet. Përpos gjykatësve kemi edhe katër organet kryesore të gjykatës edhe atë:

- Presidenca, e cila është e përbërë prej kryetarit dhe dy nënkryetarëve të gjykatës të cilët gëzojnë mandatin e tyre në kohëzgjatje prej tre vjetësh të cilët gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.
- Seksioni i apelit, e cila është e përbërë prej kryetarit dhe katër gjykatësve, ku tanimë edhe nënkuptohet fakti se gjykatësit janë të pavarur dhe nuk gëzojnë të drejtën që të veprojnë në çfarëdo profesioni tjetër.
- Byroja e prokurorisë, ky organ përbërës i gjykatës llogaritet si organ i pavarur ku prokurori dhe zëvendësit e tij ushtrojnë detyrën e tyre me orar të plotë të cilët zgjidhen nga shtetet të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e kësaj gjykate, të njëjtët janë të punësuar me afat të caktuar në kohëzgjatje prej nëntë viteve.
- Arkiva, funksionon si organ i veçantë në shërbim të punëve administrative e cila ndër vete posedon dispozita të veçanta të cilat vendosin fushëveprimin e administratës, përdorimin e gjuhëve, pagat, masat disiplinore, imunitetet, etj.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i gjykatës vlen të përmendet pasi që si parim paraqet bashkëpunim me gjykatat tjera penale ndërkombëtare edhe atë, me gjykatën e Nyrnbergut, me Tribunalin e Hagës dhe me gjykatën e Ruandës. Përpos këtyre gjykatave, gjykata e përhershme penale ndërkombëtare bashkëpunon edhe me gjykatat e shteteve të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e të njëjtës, me organizata ndërkombëtare të policisë dhe në organizatat të ndryshme regjionale. Ky bashkëpunim ndërkombëtar i obligon shtetet dhe organizatat e lartpërmendura që domosdoshmërisht të respektojnë kërkesën e kësaj gjykate, janë të detyruar edhe për implementimin e kërkesës lëshuar nga kjo gjykatë e veçanërisht duhet të garantojnë sigurinë fizike të viktimës dhe pjesëtarëve tjerë të familjes. Vlen të theksohet se ndihmë kjo gjykatë mund të kërkojë edhe nga shtetet të cilat nuk e kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e kësaj gjykate. Në raste të veçanta kur një person kërkohet të ekstradohet edhe nga kjo gjykatë edhe nga ndonjë shtet tjetër, përparësi ka gjykata.

## KAPITULLI III

### KRIMET KUNDER NJERZIMIT NË KOSOVËN E VITEVE 1997-2000

#### 3.1. Shkaqet e fillimit të Luftës në Kosovë

Konfliktet, mosmarrëveshjet dhe tensionet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve datojnë qysh në kohë të hershme, dhe vazhduan të rriten edhe më shumë gjatë shekullit XX, e me theks të veçantë gjatë Luftës së Parë Botërore, Luftës së Dytë Botërore dhe Luftës Ballkanike. Qeveria gjoja e suksesshme asokohe Socialiste e Josip Broz Titos, i shtypte idetë nacionaliste duke kontrolluar fronin në duart e veta që asnjë shtet ose kombësi të mos dominonte mbi të tjerat. Me Kushtetutën e vitit 1945 të Jugosllavisë, Kosova ishte një krahinë socialiste autonome, mirëpo kjo autonomi formale e Kosovës ishte krejtësisht diçka e pa vlerë. Shumë pak të drejta gëzonin shqiptarët, gjë që nxiti shqiptarët të krijonin Lëvizjen Revolucionare për Unitet Shqiptar në krye me Adem Demaçin, i cili u burgos nga autoritet serbe në vitin 1964 së bashku me shumë atdhetarë tjerë. Disa vite më vonë filluan demonstratat e studentëve në Beograd që më vonë u shpërndanë edhe në territorin e Kosovës. Nga e gjithë kjo rrëmujë, Kosova doli fituese vetëm në aspektin arsimor, pasi që në vitin 1970 u krijua Universiteti i Prishtinës si një institucion i pavarur.

Me hartimin e Kushtetutës së re të Jugosllavisë në vitin 1974, Kosova fitoi disa elemente që i gëzonin Republikat, edhe atë: Kuvendin e saj, një vend në presidencën federale, forcën policore, dhe Bankën Kombëtare.

Me vdekjen e Josip Broz Titos më 4 Maj të vitit 1980 nisi edhe një erë e re apo më mirë thënë krizë politike që më vonë do të vinte deri te shkatërrimi i Jugosllavisë. Mllef i shumëvjeçar i shqiptarëve të shtypur të Kosovës nga politikat e Titos, do të rezultojë në një demonstratë të madhe në Prishtinë e inicuar nga studentët e Universitetit të Prishtinës në vitin 1981, të cilat më vonë u përhapën në gjithë territorin e Kosovës. Reagimi i presidencës së Jugosllavisë ishte shumë i ashpër pasi që dërgoi në demonstrata ushtrinë dhe policinë të cilat shkaktuan shumë të vrarë. Nuk dihet numri i saktë i personave të shtypur nga forcat Jugosllave, mirëpo duke u bazuar në një raport mendohet se diku 550.000 banorë u arrestuan dhe u morën në pyetje. Gjendja do të përkeqësohej edhe më shumë në vitin 1987 kur një ushtarë shqiptarë i Ushtrisë Kombëtare Jugosllave i vrau 4 ushtarë serbë. Pas kësaj ngjarje

Slobodan Millosheviqi akuzoi disa zyrtarë të lartë serbë pasi që ishin shumë të butë me popullin shqiptarë. Këtu fillon edhe ngritja e tij në Serbi duke fituar përkrahje të madhe nga popullata serbe. Në atë periudhë në Serbi botohen artikuj të shumtë ku thuhej se prej vitit 1981 deri në vitin 1987 janë themeluar mbi 200 organizata shqiptare në Kosovë të cilët kishin për qëllim të vrasin ushtarë dhe oficer duke helmuar ushqimin dhe ujin. Kjo nxiti politikën e Slobodan Millosheviqit që të ndërmarrin masa kundër shqiptarëve duke mbajtur një memorandum ku thuhej se serbët në rajonin e Kosovës përballen me një gjenocid politik, fizik dhe ligjor. Qëllimi i këtij memorandumi ishte zvogëlimi i autonomisë së Kosovës që pati sukses me arrestimin e kryetarit të komitetit rajonal të Kosovës dhe duke shpallur gjendje emergjente në Kosovë për shkak të protestave ku humbën jetën 24 persona.

Ishte viti 1990 ku filloi edhe shkatërrimi i sistemit socialit duke vazhduar me krijimin e sistemit shumë-partiak. Marrëdhëniet shqiptaro-serbe edhe më shumë përkeqësoheshin. Në po të njëjtin vit Serbia mori kontrollin e plotë mbi Kosovën, duke marrë menaxhimin e medias kryesore shqiptare dhe duke ndaluar çdo transmetim në gjuhën shqipe, ku më vonë do të ndalej edhe botimi i gazetës ditore Rilindja, kështu duke ua marrë të drejtat bazë shqiptarëve, duke shtypur popullsinë shqiptare dhe duke shkatërruar sistemin arsimor.

Tani më kishte filluar edhe shkatërrimi i Jugosllavisë, shtetet brenda saj kërkonin ndarjen nga Jugosllavia. Gjatë asaj periudhe politika paqeruajtëse e Ibrahim Rugovës e ruante në qetësi Kosovën gjatë konflikteve të armatosura apo luftërave në Slloven, Kroaci dhe Bosnjë Hercegovinë. Shtypja e vazhdueshme e popullit shqiptar i bindi ato se vetëm rezistenca e armatosur mund të ndryshonte këtë situatë. Krijimi i një force rezistuese u vërejt në gjithë territorin e Kosovës qysh gjatë trazirave në shtetet e lartpërmendura. Kjo forcë në vitin 1996 ndërmoi katër sulme ndaj sigurisë serbe brenda territorit të Kosovës. Këto sulme i morri përsipër një organizatë e panjohur për atë kohë me emrin "Ushtria Çlirimtare e Kosovës" apo shkurtimisht UÇK. Për funksionimin e kësaj ushtrie, e cila edhe më tej ishte e panjohur si nga forcat serbe ashtu edhe nga shtetet ndërkombëtare, kishte nevoja financiare dhe materiale, të cilat i fitoi nga diaspora shqiptare. Në vitin 1997 në Republikën e Shqipërisë pati trazira të mëdha në gjithë territorin e shtetit ku u armatosën populli duke hapur kështu rezervat e armatimeve të Ushtrisë Shqiptare e që më vonë do të rrëzonin edhe Qeverinë e Shqipërisë. E gjithë kjo rezultoi pozitivisht për Kosovën pasi që i gjithë ai arsenal i armëve i dalë nga rezervat e armatimit të Ushtrisë Shqiptare përfundoi në duart e ushtarëve të UÇK-së.

Qeveria jugosllave, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e konsideronte si një organizatë terroriste të cilët gjoja qëllim kryesorë kishin të sulmonin policët dhe civilët. Të njëjtin

mendim me serbët asokohe kishin edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilët po ashtu e listuan UÇK-në si një organizatë terroriste.

### **3.2. Fillimi i Luftës së Kosovës**

Situata vazhdonte të përkeqësohej edhe më shumë, llogariteshin si vite dramatike, vitet e fillimit të një kthese të madhe, ndryshe thënë vitet e fundit për jetë a vdekje. Sulmet e UÇK-së çdo ditë shtoheshin, ishte periudhë kohore ku llogaritej se Kosova ishte në fazën e fundit të sundimit serb. E kemi theksuar edhe më lartë se shumë të drejta themelore serbët ua kishin marrë shqiptarëve, ndër tjerash edhe në Universitetin e Prishtinës rektor e kishin zgjedhur Radovan Popoviqin i cili kishte uzurpuar hapësirat e Universitetit dhe i kishte larguar të gjithë studentët shqiptarë nga ndërtesat e Universitetit. Një ndër sulmet e theksuara të nisjes së luftës ishte edhe atentati i kryer ndaj rektorit serb, si dhe vrasja e tre pjestarëve të UÇK-së Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut.

Dalja për herë të parë në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndodhi më 28 Nëntor 1997 ku në një varrim morën pjesë mbi 20.000 persona ku mbeti i vrarë një mësues nga policia serbe në fshatin Llaushë të Skenderajt. Tani më UÇK-ja kishte filluar të krijojë zonat e saja të lira. Lufta e Kosovës filloi më 28 Shkurt të vitit 1998 pas masakrës së kryer nga forcat serbe në fshatrat Likoshan dhe Qirez të Drenicës. Në këto fshatra ndodhi përleshja e parë ndërmjet pjestarëve të UÇK-së dhe forcave policore serbe ku mbetën të vrarë 24 persona mes të cilëve edhe një grua shtatzënë. Disa ditë më vonë forcat serbe vazhduan sulmet kundër komandantit legjendar Adem Jasharit dhe gjithë Jasharajve të cilët u bënë simbol i kombit shqiptar të Kosovës. Adem Jashari u ndoq nga forcat serbe për një kohë të gjatë dhe u rrethua në Prekaz të poshtëm. Nga kjo betejë që zgjati plot katër ditë ndërmjet Jasharajve dhe forcave të armatosura serbe mbetën të vrarë dhe u masakruan 58 persona shumica e të cilëve ishin gra dhe fëmijë, gjegjësisht 18 gra dhe 10 fëmijë. Kjo ngjarje e rëndë e rënies së Jasharajve legjendarë preku thellë çdo shqiptarë jo vetëm në Kosovë por në mbarë botën. Kjo masakër nxiti çdo shqiptar të Kosovës të mobilizohet dhe të luftojnë kundër forcave serbe për çlirimin e vendit. Kjo masakër ua tërhoq vëmendjen SHBA-ve, Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Lirisht mund të thuhet se këto masakra të lartpërmendura ishin zanafilla e një lufte të pashmangshme ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.

Vitet 1998 dhe 1999 ishin vitet më të rënda të historisë së Kosovës pasi që ndodhën shumë masakra në gjithë territorin e Kosovës dhe u hapën shumë varre masive.



Pas masakrës ndaj popullit civil, në fshatrat Likoshan e Qiraz e më vonë në Prekaz të Poshtëm, forcat serbe kryen edhe një tjetër masakër më 10 Maj 1998 ku familjes Deliaj ua morën 11 veta për të cilët ende nuk ka asnjë gjurmë, dhe masakruan 22 anëtarë civil të po të njëjtës familje. Më 29 Shtator 1998, për këtë rast HUMAN RIGHTS WATCH mes tjerash ka deklaruar:

*“Human Rights Watch e viziton skenën më 29 Shtator ndërsa kufomat po nxirreshin nga pylli për tu varrosur. 14 viktimat ishin me rroba civile, shumica ishin goditur nga distanca e afërt, ndërsa disa kufoma ishin sakatuar. Në një rast këmba e 62 vjeçares Havë Deliaj ishte prerë poshtë gjurit. Përveç 14 personave të vrarë në pyll 7 pjesëtarë të familjes Deliaj u vranë nga forcat qeveritare pranë shtëpisë së banimit. Plaku i familjes 91 vjeçari Fazli Deliaj, invalid u gjet i vdekur në shtëpinë e tij të djegur. Habibe dhe Hisen Deliaj u ekzekutuan në prani të fëmijëve. Adem Deliaj gjet me fytyrë prerë ndërsa kufomat e tre vajzave u gjetën të masakruara në të njëjtën zonë të krimit”.*<sup>29</sup>

Ky imazh i stërm bushur me gjak i siguroi ndërkombëtarët për krimet që kryhen ndaj popullit civil në Kosovë. Në ndërkohë UÇK-ja ruante avantazhin e vetë, e rrethoi Pejë dhe Gjakovën, ndërsa si krye qytet provizor e llogaritshin Malishevën, pastaj më vonë futen në Therandë, Rahovec dhe veri-perëndim të Prishtinës. Masakrat e forcave serbe nuk kishin të ndalur.

Në fillim të vitit 1999 vazhduan me Masakrën e Reçakut ku u vranë dhe masakruan 55 civilë të pa armatosur të fshatit Reçak të Shtimes. Më vonë do të ndodh edhe masakra e fshatrave të rajonit të Pejës ku u vranë dhe masakruan mbi 100 persona civil të armatosur, raste këto për të cilat do të njihemi në vazhdim më hollësisht.

### **3.3. Masakrat dhe krimet kundër njerëzimit në Kosovën e viteve 1997-1999**

#### **3.3.1. Masakra e Çukisë dhe Ljubeniçit**

Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë janë të shumta. Zoran Rashkoviç është dëshmitar i gjallë i cili në vitin 2010 vendosi që të dëshmojë haptazi, pa mos u fshehur në një gjykatë në Beograd për krimet e luftës së Kosovës dhe vrasjen e mbi 100 shqiptarëve civil në fshatrat e rajonit të Pejës. Zoran Rashkoviç është i lindur në Rijekë-Republika e Kroacisë, në vitin 1978, ai për shkak të trazirave të viteve të 90-ta kthehet në vendlindjen e të atit, në një fshat

---

<sup>29</sup> Kosova në vitet 1997-1999, Jakup Krasniqi.

të Pejës. Ai është dëshmitar i gjallë i vrasjes së mbi 200 shqiptarëve civil të pafajshëm, përfshirë këtu edhe gra dhe fëmijë, për ndjekjen dhe dëbimin nga shtëpitë e tyre të mbi 10.000 shqiptarëve.

Kur Sllobodan Millosheviqi erdhi në pushtet në Kosovë, Zoran Rashkoviç kishte vetëm 17 vjet dhe tregon se si në atë kohë serbët i konsideronin shqiptarët si qytetarë të rendit të dytë dhe pranon se kanë qenë të manipuluar dhe të paguar që të kryejnë krime të rënda luftime në Kosovë. Zoran Rashkoviç ka qenë anëtarë i një grupi kriminelësh të njohur me emrin “çakallët” të cilët ndryshe janë njohur edhe si qentë e luftës që janë paguar të kryejnë përdhunime, vrasje, masakra nga më të ndryshmet në fshatrat e Pejës, dmth ky grup ka qenë i paguar nga autoritetet serbe që të kryejnë punët më të pista gjatë luftës. Anëtarët e grupit “çakallët” një ditë marrin urdhër që të shkojnë në fshatin Çuski. Arsyeja kryesore e shkuarjes në këtë fshat ku çakallët vranë më shumë se 40 civil, dogjën shtëpi dhe dëbuan mbi 400 persona nga shtëpitë ishte për shkak se ky fshat ishte vendlindja e Agim Çekut-ish liderit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë sulmit shtëpia e Agim Çekut u dogj dhe babai i tij Hasan Çeku mbeti i vrarë. Zoran Rashkoviç tregoi për sulmet e ndodhura atë ditë në atë fshat, ku thotë se pasi ua kanë djegur shtëpitë, i kanë grumbulluar meshkujt civil nga 10-15 persona i kanë ndarë në disa grupe nëpër shtëpitë e ndryshme duke i mashtruar se gjoja presin policinë për ti legjitimuar mirëpo më vonë të njëjtit ekzekutohen.

Nebojsa Miniç, ishte udhëheqës i çakallëve me pseudonimin “mrtvi” i cili asnjëherë nuk u dënua penalisht për krimet makabre të kryera pasiqë kishte humbur jetën nga sida në Argjentinë. E vërteta edhe më e hidhur qëndron në faktin se pjesëtarët tjerë të grupit çakallët shëtiten të lirë rrugëve të Beogradit. Vlen të theksohet një pjesë e rrëfimit të Zoran Rashkoviçit kur thuhet se Nebojsa Miniç-mrtvi në mesin e të vrarëve ka lënë gjallë një 16 vjeçar me qëllim që të nesërmen të ketë një dëshmitar që tu tregojë shqiptarëve për punën që kanë kryer çakallët dhe ta shpërndajë frikën tek pasardhësit nëpërmjet përjetimeve të tij.

Për fat të keq Çuskia nuk ishte vend i vetëm ku zbarkuar çakallët, ata shkuan edhe në fshatin Ljubeniç ku dëbuan banorët e këtij fshati nga shtëpitë e tyre, përdhuan gratë dhe vajzat e reja, ua dogjën shtëpitë, ndërsa burrat e fshatit i grumbulluan në qendër dhe të gjithë i ekzekutuan të cilët ishin në numër rreth 66. Vlen të theksohet se viktimat nuk kanë pasur asnjë lloj arme, kanë qenë njerëz të thjeshtë dhe ndaj tyre është kryer një masakër e paparë.

Kjo periudhë kohore, mund të llogaritet si çrregullim total kohor, ku budallenjtë flasin, të mençurit heshtin dhe të varfëritë pasurohen. Kjo njësi paramilitare serbe e njohur me emrin çakallët, është përgjegjëse për masakrat brutale që ndodhën në Ljubeniç, Pavlan, Zahaç dhe Çuski, të gjitha këto fshatra të rajonit të Pejës.

### 3.3.2. Masakra e Reçakut

Pas disa masakrave të njëpasnjëshme nga forcat serbe, ndodhi edhe Masakra e Reçakut ku mbetën të vrarë 45 civil në vitin 1999. Kjo masakër u organizua dhe u realizua nga forcat policore dhe ushtarake serbe, edhe pse vetë Serbia mohon të ketë qenë masakër duke thënë se shqiptarët e vrarë kanë qenë ushtarë të UÇK-së. Sipas dëshmitarëve të cilët i kanë mbijetuar masakrës së fshatit Reçak që gjendet në Qendër të Kosovës, kjo ngjarje ka filluar qysh në kohët e hershme të mëngjesit më datë 15 Janar 1999. Në atë ditë banorët e Reçakut janë zgjuar të rrethuar në të gjitha anët nga forcat policore dhe ushtarake serbe të cilët kanë filluar të granatojnë fshatin me artileri të rëndë. Pas përfundimit të granatimeve forcat serbe janë futur në fshat duke filluar kështu bastisje në çdo shtëpi. Në këto momente tragjike banorët e fshatit u munduan të ikin nga fshati por diçka e tillë ka qenë e pamundur nga shkakut se i gjithë fshati ka qenë i rrethuar nga forcat serbe, e vetmja rrugëdalje ka qenë të grumbullohen në bodrumet e disa shtëpive. Forcat serbe janë futur në fshat nga rruga kryesore, ku duke u bazuar në rrëfimet e dëshmitarëve okularë ata janë ndalur në shtëpinë e Rashit Rashitit ku arrestojnë Banush Kamberin të cilin e malltetojnë fizikisht e më pas e ekzekutojnë. Ekzekutimi nuk ka kënaqur egon e barbarëve serb, ata pas ekzekutimit personit në fjalë ia këpusin edhe kokën të cilën më vonë nuk e kanë gjetur në vend ngjarje. Në këtë formë është vazhduar masakra në çdo shtëpi të fshatit Reçak duke bastisur dhe djegur të njëjtat.

Pjesa më tragjike e kësaj dite ndodhi në shtëpinë e Sadik Osmanit. Forcat serbe kishin hetuar se në këtë shtëpi janë grumbulluar një numër i konsiderueshëm i banorëve të fshatit, ata filluan të gjuajnë nga largësia me armë të ndryshme, e më pas rrethojnë shtëpinë dhe futen në oborr. Në bodrumin e kësaj shtëpie kanë qenë të grumbulluara rreth 30 gra me fëmijë, disa burra dhe djem të rinj, ndërsa në ahurin e lopëve kanë qenë të grumbulluar rreth 30 burra të fshatit. Gjithmonë duke u bazuar në rrëfimet e dëshmitarëve okular si Ramë Shabani dhe Sadije Ramadani, forcat serbe i nxjerrin burrat prej ahuri dhe këta të tjerët prej bodrumi, të gjithë në oborr ua marrin dokumentet e identifikimit, e më pas gratë dhe fëmijët i mbyllin në bodrum të cilat kanë përjetuar tmerr nga përdhunimet dhe lëndimet trupore që i kanë marrë në sy të fëmijëve, ndërsa të gjithë burrat, i shtrijnë për tokë në oborr dhe i kanë rrahur me mjete të ndryshme. Më pas do të ndodh edhe më e keqja, pas një orë rrahje pa ndërprerë, i rreshtojnë burrat në kolonë dhe i dërgojnë në mal tek e ashtuquajtura "Gropa e Bebushit" ku edhe i ekzekutojnë nga afër me rafalë automatiku 29 burra, vlen të përmendet se 5 prej tyre arrijnë të shpëtojnë gjallë.

Ambasadori i OSBE-së në Kosovë një ditë pas kësaj masakre qëndroi në Reçak dhe tek “Gropa e Bebushit” dhe i pa nga afër masakrat që kishin realizuar forcat serbe. Në një deklaratë për gazetarët ai mes tjerash tha: *Nga ajo që pashë nuk nguroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit. Kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time.*<sup>30</sup>

### 3.3.3. Masakra e Burgut të Dubravës

Burgu i Dubravës ishte burgu më i madh në Kosovë, me një kapacitet rreth 1,000 të burgosur, i vendosur në Veri Perëndim të Kosovës, afër kufirit me Malin e Zi.

Avokatët mbrojtës nuk lejoheshin të hynin brenda në burg, ata mbanin kontakte të fshehura me të burgosurit prej të cilëve dolën edhe raporte të besueshme se brenda burgut ndodhin tortura dhe abuzime nga më të ndryshmet gjatë vitet 1998 dhe 1999. Shumë të burgosur kishin bërë ankesa nga lëndimet trupore që i kishin marrë prej torturave dhe abuzimeve që kishin përjetuar, e që kishin përfunduar me koska të thyera dhe dështim të veshkave. Brenda viteve 1998 dhe 1999 mendohet se pesë persona humbën jetën si rezultat i rrahjeve dhe torturave me mjete nga më të ndryshmet. Në Burgun e Dubravës ishin transferuar edhe 143 shqiptarë të arrestuar në Gjakovë në Maj të vitit 1999.

Duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve të cilët i mbijetuan Masakrës në Burgun e Dubravës në mëngjesin e 2 Majit të vitit 1999 rreth një mijë të burgosurve u ishte thënë të rreshtohen në fushën e sportit duke i mashtruar se do ti transferonin në ndonjë burg më të sigurtë. Ata qëndruan të rreshtuar disa minuta e më pas janë hedhur katër granata dore dhe është gjuajtur me snajper dhe armë të ndryshme drejt të burgosurve nga të gjitha anët e burgut. Person që i mbijetoi masakrës ishte edhe ish anëtari i Kuvendit të Kosovës i cili mes tjerash deklaroi: *Na morën në një vend rrethuar e dendur me roje, pastaj filloi gjuajtja. Gjuanin nga të gjitha anët me granata dhe me armë, nuk shihej asgjë tjetër përveç zjarrit dhe gjakut.*<sup>31</sup>

Gjatë kësaj Masakre disa të burgosur kanë arritur të fshihen në bodrumet dhe sistemin e kanalizimit të burgut. Brenda natës forcat e rendit sulmuan disa pjesë të brendshme të burgut, ndërsa të nesërmen në mëngjes hodhën granata në pjesën u ishin rreth 150 të burgosur e të lënduar. Në një pjesë tjetër në bodrumin e burgut, rreth 28 të burgosur u sulmuan me thika nga forcat serbe nga ku thuhet se organet e njerëzve janë hedhur gjithkund. Pas përfundimit të

<sup>30</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra\\_e\\_Re%C3%A7akut](https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Re%C3%A7akut) “Masakra e Reçakut”, Sheradin Berisha.

<sup>31</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra\\_e\\_Burgut\\_t%C3%AB\\_Dubrav%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Burgut_t%C3%AB_Dubrav%C3%ABs)

sulmit të gjithë të mbijetuarit e masakrës janë transferuar në burgjet e Serbisë disa prej të cilëve u liruan pas përfundimit të luftës.

Gjatë kryerjes së kësaj masakre brutale në burgun e Dubravës ngelën të vrarë 99 të burgosur dhe mbi 200 të plagosur. Ish deputeti i Kosovës Ukë Thaçi, dha një deklaratë në lidhje me autorët e kësaj masakre ku thotë: *Masakra e Dubravës ishte një masakër e organizuar ndërmjet stafit të burgut policisë dhe ushtrisë, ishte një planifikim i shtetit serb, sepse policia dhe ushtria serbe ishin të vendosura brenda objekteve të burgut.*<sup>32</sup>

### **3.4. Numri i viktimave në Kosovën e viteve 1997-1999**

Lufta e Kosovës fillimi i së cilës njihet data 22 Shkurt 1998 mori jetën e rreth 13.500 njerëzve. Sipas të dhënave numrin më të madh të viktimave e përbejnë shqiptarët, rreth 10.800 viktima, serb 2.200 viktima dhe të tjerë 530 viktima (romët boshnjakët, malazezët).

Rreth 2.400 viktima ishin ushtarë të UÇK-së, kurse pas mbarimit të Luftës, mbi 5.000 viktima figuronin si të zhdukur, fati i 1.900 personave nuk dihej edhe 21 vjet pas mbarimit të luftës.

Një nga betejat më të përgjakshme të Luftës së Kosovës është Beteja e Koshares, e cila u zhvillua më 9 Prill të vitit 1999, ku gjetën vdekjen 155 Ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe 81 ushtarë serb.

Në tabelën në vazhdim kemi paraqitur numrin e viktimave civilë në bazë të komunave dhe nacionalitetit, si dhe numrin e ushtarëve të vrarë sipas komunave dhe përkatësisë etnike, shqiptarë dhe serb. Të dhënat janë nga Fondi për të Drejta Humanitare, i cili fond në vitin 2015 prezantoi Librin e Kujtimeve të Kosovës.<sup>33</sup>

---

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup>

<http://www.gazetatribuna.com/lajme/mesoni-se-sa-ishte-numri-i-viktimave-te-luftes-se-kosoves/>

Tabela nr. 1

Lista për humbjen e civilëve dhe ushtarëve sipas komunave

Komuna	Civilë të humbur sipas komunave		Ushtarë të humbur sipas komunave	
	shqiptarë	serb	shqiptarë	serb
<b>Gjakovë</b>	1022	61	361	151
<b>Skenderaj</b>	984	16	166	69
<b>Glllogoc</b>	804	10	156	97
<b>Rahovec</b>	724	71	102	16
<b>Pejë</b>	561	79	111	46
<b>Prishtinë</b>	466	130	77	59
<b>Prizren</b>	464	80	185	74
<b>Vushtrri</b>	451	31	55	25
<b>Suharekë</b>	434	40	97	53
<b>Mitrovicë</b>	417	32	67	26
<b>Podujevë</b>	376	28	71	33
<b>Malishevë</b>	326	/	48	40
<b>Deçan</b>	228	14	212	53
<b>Istog</b>	204	39	109	17
<b>Klinë</b>	189	56	36	29
<b>Lipjan</b>	184	43	15	15
<b>Kaçanik</b>	152	9	83	17

<b>Fushë Kosovë</b>	129	29	/	6
<b>Ferizaj</b>	121	32	27	18
<b>Gjilan</b>	105	98	15	10
<b>Shtime</b>	94	7	46	15
<b>Obiliq</b>	75	18	15	/
<b>Viti</b>	37	34	16	8
<b>Zubin Potok</b>	30	/	/	/
<b>Zveçan</b>	19	/	/	/
<b>Kamenicë</b>	17	30	10	6
<b>Shtërpcë</b>	11	7	2	/
<b>Shqipëri</b>	11	/	5	/
<b>Dragash</b>	10	/	3	6
<b>Rozhaj</b>	9	/	8	/
<b>Plavë</b>	4	/	9	/
<b>Beograd</b>	2	/	/	15
<b>Nish</b>	/	20	/	5
<b>Varvarin</b>	/	10	/	/
<b>Leskovac</b>	/	10	/	/
<b>Novi Pazar</b>	/	8	/	/
<b>Vojvodinë</b>	/	8	/	12
<b>Bujanovc</b>	/	/	6	8
<b>Preshevë</b>	/	/	4	10

<b>Tetovë</b>	/	/	1	/
<b>Pozharevac</b>	/	/	1	/
<b>Smederevë</b>	/	/	/	4

### 3.5. Intervenimi i NATO-s në Kosovë

Lufta në Kosovë tanimë kishte marrë përmasa të mëdha dhe u thyen të gjitha rregullat e luftës duke kryer masakra nga më të ndryshmet. Pra, problemi i Kosovës llogaritej si problem territorial shtetëror që historikisht shumicën e popullatës vendore e kishte shqiptare. Prandaj si rast i tillë lindi nevoja që ky problem të trajtohet në ndonjë mënyrë tjetër pak më serioze duke organizuar kështu ndonjë konferencë ndërkombëtare apostafat për Kosovën ku përveç përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre serb të marrin pjesë edhe ndërmjetësues nga forcat e mëdha botërore. Problemi i Kosovës ishte rrezik shumë i madh për destabilizimin e shteteve përreth dhe disa shteteve të Evropës Juglindore. Lirisht mund të thuhet se rruga kryesore për ta destabilizuar të gjithë Ballkanin kalonte nëpër Kosovë.<sup>34</sup>

Dëshira e madhe e shqiptarëve për krijimin e një shteti të pavarur, sakrificat e tyre të panumërta, luftimet e tyre kundër forcave të xhindosura serbe, masakrat e kryera ndaj popullatës civile, rritje e numrit të refugjatëve, të gjitha këto ndikuan që të krijohet një operacion ushtarak nga ana e NATO-s kundër Serbisë, për të ndihmuar shqiptarët nga krimet kundër njerëzimit që realizoheshin nga ana e forcave serbe. Disa analistë këtë operacion apo ndërhyrje nga ana e NATO-s e inicoi lufta dhe sakrifica e familjes së komandantit legjendar Adem Jasharit, ndërsa disa analistë të tjerë mendojnë se vendimtare për ndërhyrje ishte masakra e Reçakut. Me fjalë të tjera, lirisht mund të thuhet se vendimtare ishte terrori dhe masakrat që kryheshin ndaj popullatës civile në gjithë territorin e Kosovës.

Hapat e para që u ndërmorën kundër Serbisë ishin në Prill të vitit 1998 nga ana e OKB-së të cilët i kishin vendosur embargo për armët, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me disa shtete aleatë të tyre në Evropë kishin vendosur sanksione ekonomike kundër Serbisë. Në momentet kur vendosej armëpushim, serbët asnjëherë nuk e respektonin atë dhe thonin që janë shqiptarët ato që e prishin armëpushimin. Diplomacia amerikane dhe ajo evropiane nuk

<sup>34</sup> 'Pas Dejtonit Kosova brengë e bashkësisë ndërkombëtare', Shkup, 2005, faqe 251.



hiqnin dorë prej rrugëve diplomatike.<sup>35</sup> SHBA-të dërguan një përfaqësues diplomatik në Beograd për të bindur Millosheviqin që të ndërpret luftimet, mirëpo edhe ky tentim dështoi. Prandaj, më 13 Tetor të vitit 1998 NATO-ja kishte dalë me një kërcënim të hapur se do të sulmonte Serbinë brenda katër ditësh, në qoftë se nuk respektoheshin të gjitha rezolutat e Kombeve të Bashkuara të miratuara për ngjarjet në Kosovë.<sup>36</sup> Serbia e ishte marrë shumë seriozisht këtë kërcënim dhe tërhoqi 4,000 oficerë nga Kosova, gjest i cili dha një shpresë të madhe për arritjen e paqes duke anuluar kështu sulmet ajrore të NATO-s. Besnikëria e serbëve nuk zgjati shumë, ata në Janar të vitit 1999 përsëri filluan të vrasin dhe masakrojnë popullatën civile në Kosovë. Problemi i Kosovës nxiti edhe bisedime ndërmjet forcave të mëdha botërore, atyre të SHBA dhe Ruisë të cilët ndanin të njëjtin mendim mirëpo dallonin në thelbin e problemit, ku SHBA mendonin se problem kryesorë i kësaj lufte ishte Millosheviqi dhe politikat e tij, ndërsa Rusia mendonte se problemi kryesorë qëndronte te Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Në zyrat e NATO-s, kishin ardhur në përfundim se Millosheviqi kishte katër qëllime kryesore, edhe atë:

- *Ta shkatërronte UÇK-në;*
- *Ta ndryshonte përgjithmonë strukturën etnike të Kosovës;*
- *Ti frikësonte shqiptarët që kishin mbetur në Kosovë në mënyrë që ti nënshtroheshin;*
- *Të shkaktonte një krize humanitare me të cilën do ta destabilizonte Kosovën, do ta shqetësonte komunitetin ndërkombëtar dhe do ta përçante rajonin.*<sup>37</sup>

Pushteti fashist i Mollosheviqit duke përdorur të gjitha mjetet e një ushtrie dhe policie kriminele, Kosovën e ktheu në një varrezë dhe në një tokë të djegur, në mënyrë që të ishte e pavlerë për të gjithë.<sup>38</sup>

Në kërkim të një zgjidhjeje, diplomacia e SHBA-ve dhe shteteve kryesore të Evropës u takuan në Rambuje të Francës ku diskutuan për arritjen e një marrëveshjeje për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë dhe mbrojtjen e shqiptarëve nga forcat serbe. Diplomati spanjoll Javier Solana në atë kohë ishte sekretar i përgjithshëm i NATO-s, ndërsa gjenerali i përgjithshëm

---

<sup>35</sup> 'Intervenimi i NATO-s në Kosovë', Nusret Pllana, Prishtinë 2010, faqe 239.

<sup>36</sup> Po aty, faqe 239.

<sup>37</sup> Po aty, faqe 241.

<sup>38</sup> "Kosova dhe UÇK-ja", Llana Kudusi, Tiranë 2005, faqe 376.

ishite Uesli Klark. Medlin Olbrajd ishte sekretarja e SHBA-ve e cila ishte në bisedime të drejtpërdrejta me kreun e NATO-s dhe presidentin e SHBA-ve Bill Clinton, bashkë me homologun e saj britanik Robin Huk, të cilët bashkërisht ndiqnin nga afër situatën e Kosovës.

Sulmet ajrore të ndërhyrjes së NATO-s filluan më 24 Mars të vitit 1999 dhe do të vazhdonin për 11 javë.<sup>39</sup> Edhe përpos kësaj ndërhyrje forcat serbe nuk u ndalën, ata vazhdonin të vrisnin shqiptarë civil, të digjinin shtëpitë dhe të dëbojnë afër 1 milion shqiptarë nga vendlindja e tyre. Bombat e forcave të NATO-s do të shkaktonin dëme të mëdha në infrastrukturën ushtarake dhe ekonomike të Serbisë.<sup>40</sup> Sulmet ajrore nuk mjaftuan, gjë që detyroi NATO-n të kalojë në fazën e dytë e cila me urdhër të Javier Solanës do të shkatërronte mjetet e artilerisë dhe makinerisë serbe të luftës që kryente krime lufte dhe krime kundër njerizimit në Kosovë. Mirëpo nga ana tjetër, shqiptarëve u ishte thënë se do të duhej të vetë organizohen, për t'iu kundërvënë akteve kriminale të forcave ushtarake dhe policore serbe.<sup>41</sup> Edhe kundrejt faktit se NATO-ja po sulmonte pikat serbe në Kosovë dhe Serbi, situata sa vinte e përkeqësohej, kjo shtyu që NATO-ja të sulmojë edhe me anë të helikopterëve të njohur me emrin “APACHE” të cilët ishin të stacionuar në Gjermani. Për realizimin e sulmeve ajrore u kërkua leje edhe nga Qeveria e Maqedonisë për shfrytëzimin e aeroportit të Shkupit për të cilën mendohej se është nën vëzhgimin e disa raketave serbe.

Në Prill të vitit 1999, në Kosovë vriteshin shqiptarë të pafajshëm, ndërsa në Beograd u sulmuan Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë, selia e partisë së Millosheviqit dhe në fund edhe shtëpia e tij. Mirëpo, në anën tjetër Millosheviqi ende nuk ishte dorëzuar.<sup>42</sup> Vlen të përmendet se kryeministër i Shqipërisë në atë kohë ishte Pandeli Majko i cili kishte siguruar të gjitha kushtet e nevojshme që kishte kërkuar NATO-ja, i kishte lënë të gjitha objektet e Qeverisë në dispozicion të NATO-s. Në Shqipëri ishin vendosur shumë trupa të NATO-s, mes tjerash edhe helikopterë të tipit “APACHE”.

Politikat e fëlliqura të Millosheviqit u munduan me çdo kusht që nëpërmjet Ruisë dhe Kinës ti tregojnë botës se sulmet e NATO-s nuk ishin asgjë tjetër veçse një akt agresioni. Kjo politikë nuk pati sukses pasi që diplomatët e vendeve të G8 (SHBA, Rusia, Japonia, Italia, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Kanada) arritën një marrëveshje formale prej shtatë

---

<sup>39</sup> “Intervenimi i NATO-s në Kosovë”, Nusret Pllana, Prishtinë 2010, faqe 246.

<sup>40</sup> “Rruga e lirisë”, Nusret Pllana, Prishtinë 2000, faqe 16,

<sup>41</sup> “Jeta ime”, Bill Clinton, Tiranë 2005, faqe 715.

<sup>42</sup> “Intervenimi i NATO-s në Kosovë”, Nusret Pllana, Prishtinë 2010, faqe 254.

pikave me qëllim të arritjes së paqes në Kosovë. Në këtë marrëveshje, pikë kryesore ishte tërheqja e forcave serbe nga Kosova dhe dërgimi i një force ndërkombëtare paqeruajtëse në Kosovë e kryesuar nga NATO-ja. Më në fund, NATO-ja dhe Rusia ranë dakord dhe hartuan një plan me detyra që duhej ti përmbushte Millosheviqi dhe të ndalte luftën. Ndërkohë iu bë me dije Millosheviqit se propozim më të mirë nuk kishte dhe se ky plan ishte i fundit me mbështetjen ruse. Qeveria serbe në krye me Millosheviqin nuk pati zgjidhje tjetër përpos të pranojë këtë ofertë dhe të kërkojë nga parlamenti që të miratohet. Në këtë formë do të përfundojë edhe lufta mes Kosovës dhe Serbisë, ku me 9 Qershor të vitit 1999 u arrit marrëveshja përfundimtare e tërheqjes së menjëhershme të forcave serbe nga Kosova dhe vendosjen e një force ndërkombëtare paqeruajtëse prej 48,000 personash në gjithë territorin e Kosovës.

Në këtë mënyrë, pas 79 ditë bombardimesh të vazhdueshme të forcave të NATO-s përfundimisht u krijuan kushtet elementare për kthimin e afër 1 milion njerëzve, të nxjerrë me forcë nga tokat e tyre.<sup>43</sup>

---

<sup>43</sup> "Jeta ime", Bill Clinton, Tiranë 2005, faqe 721.

## KAPITULLI IV

### SHKATËRRIMI I ISH-JUGOSLLAVISË, KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT, KRYERËSIT E TYRE DHE

#### DËNIMET NGA GJYKATA E HAGES PËR SHTETET E ISH JUGOSLLAVISË

##### 4.1. Shpërbërja e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë

Për shpërbërjen e Jugosllavisë ekzistojnë disa mendime, mirëpo kuptimi i shpërbërjes ishte i përgjithshëm pasi që vinte si rezultat i tensioneve etnike brenda shteteve përbërëse të ish Jugosllavisë. Në kohën kur këto tensione nuk mund më të kontrolloheshin kriza në Ballkan mori një rrugë drejt shpërbërjes siç ishte edhe vet Jugosllavia e viteve të 90-ta. Shtete e Bashkuara të Amerikës gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm pasi që qëndrimet e tyre politike dhe makroekonomike e bënë të mundur shkatërrimin e Jugosllavisë, luftërat e përgjakshme që i kishte shkaktuar Serbia ishin si rrjedhojë e ngjarjeve të cilët i dhanë edhe fund shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Jo rastësisht përmendëm edhe ndikimin e SHBA-së nëpërmjet qëndrimeve politike dhe makroekonomike pasi që një vit para shkatërrimit RSFJ-së Kongresi i Shteteve të Bashkuara miratoi një ligj për fondet dedikuar vendeve të huaja e cila hyri në fuqi brenda gjashtë muajsh. Politika asokohe amerikane mori vendim që të ndërpresë të gjitha fondet të cilat ishin dedikuar për ndihmë të drejtpërdrejtë RSFJ-së. Kusht i vetëm për vazhdimin e financimit të këtyre fondeve kundrejt RSFJ-së ishte që të gjitha Republikat Jugosllave të kishin zgjedhje shumpartiake të ndara. Ky kusht u interpretua në mënyra të ndryshme mirëpo sidoqoftë dihet që financat nga ana e Amerikës kishin hyrë në të gjitha mjediset shoqërore ku edhe kishin filluar lëvizjet demokratike dhe krijimi i partive të ndryshme.

Shumë analistë asokohe e komentonin këtë lloj krijese siç ishte RSFJ-ja ku thuhej se Jugosllavia ishte një vend ku njerëzit jetonin bashkë e krijuar nga Titoja e cila kishte një sukses të madh në sferën ekonomike. Lind pyetja se pse kjo krijesë kaq e suksesshme të shkatërrohet? Përgjigja ishte se filluan papritur pakënaqësitë dhe shpërthimi i tensioneve etnike, fakt tjetër që nxiti konfliktet etnike ishte edhe kriza ekonomike e nxitur nga politikat e Perëndimit diku në vitet e 80-ta që për fat të keq e përfshinë edhe Jugosllavinë. Analisti

amerikan Xhorxh Vid Tomasheviq tha: ndarja e federatës jugosllave, jo e përkryer, do të ishte paraprakisht e pamundur pa një operacion kirurgjik, politik, ekonomik, drastik dhe të egër, që në rastin më të mirë nuk do të kishte kënaqur plotësisht asnjërin nga pjesët. Të gjitha hipotezat e kënaqshme ta divorcit ndërmjet Serbisë e Kroacisë pas vete do të kishin edhe një ndarje të dhimbshme të Bosnje Hercegovinës ku do të ngrihej edhe çështja shpërthyes e identitetit të muslimanëve jugosllav, duke shkaktuar këmbime dramatike të popullsisë, pasi mijëra serb e kroat do të zhvendoseshin nga trojet në fjalë.<sup>44</sup>

Më 11 Mars të vitit 1981 në Universitetin e Prishtinës ndodhi një ngjarje e cila lirisht mund të thuhet që është edhe fillimi i shpërbërjes së RSFJ-së. Në këtë Universitet shpërthyen demonstratat studentore të cilët kërkonin që të ndaleshin padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve të Kosovës. Këto demonstrata filluan të marrin edhe përmasa të pakontrollueshme, po në atë vit filloi të përshkallëzohet edhe më shumë situata. Pikërisht për këtë ngjarje reagoi edhe Ministri i Brendshëm i Jugosllavisë i cili ishte i detyruar që të pranojë edhe publikisht se nuk janë demonstrata të thjeshta por janë demonstrata masive të shpërndara në gjithë territorin e Kosovës. Këto demonstrata trazuan edhe mbarë opinionin publik të Jugosllavisë dhe pas një kohe të shkurtër njerëzit filluan të kuptojnë së për çfarë lloj demonstratash bisedohet duke rrëzuar kështu edhe shpifjet që dilnin nga Ministri i Brendshëm i Jugosllavisë. U bënë shumë përpjekje që këto lëvizje në Kosovë ti lidhnin me kushtet e dobëta ekonomike mirëpo realiteti ishte krejt ndryshe pasi që me anë të këtyre demonstratave shpërtheu edhe nacionalizmi shqiptarë ku disa vjet më vonë këto ngjarje ndikuan drejtpërdrejtë në shpërbërjen e Jugosllavisë. Disa politikanë slloven i komentuan këto lloj demonstratash duke thënë se janë si rezultat i zhvillimit të sistemit politik të dobët të Jugosllavisë. Një fakt tjetër i dhimbshëm ishte edhe se shqiptarët në vitin 1991 nuk i konsideronin si pjesë të Jugosllavisë duke anashkaluar kështu edhe në regjistrimin e popullsisë.

Të gjithë shtetet përbrenda Jugosllavisë duke filluar nga Sllovenia e deri tek Kosova filluan të mendojnë seriozisht për tu shkëputur nga kjo përbërje e quajtur Jugosllavi mirëpo nuk ishin të vetëdijshëm për rrezikun që bartshin gjatë këtyre veprimeve. Lidhja e komunistëve të Jugosllavisë në Kongresin e saj të fundit nxori në shesh krizën jugosllave e cila bazën e kishte shumë më herët. E tërë Republika Sociale Federative e Jugosllavisë përbrenda saj kishte një numër të madh pakënaqësish brenda vetes mirëpo ishte Josip Broz

---

<sup>44</sup> Intervenimi i Natos në Kosovë, Nusret Pllana, Prishtinë, 2010, faqe 40.

Tito personi që në mënyrë perfekte e ruante këtë lloj krijese duke menaxhuar me një numër të madh etnitetesh, me krizën ekonomike që çdo ditë rritej, me kamatat e borxheve që arritën vlerën e miliarda dollarëve. Pas vdekjes së Titos kjo gjendje bëri që Jugosllavia të trashëgoj një borxh shumë të madh duke qenë kështu edhe vendi i parë në gjithë Evropën, gjë që rezultoi me rritjen e shpejtë të krizës. Nga kjo ngjarje lindi edhe një problem i madh pasi që të gjitha shtetet që qëllim kryesor e kishin të ndaheshin nga kjo krijesë nuk donin që me vete përveç lirisë të trashëgojnë edhe borxhet, gjë që ngelet problem ndërkombëtar edhe sot e kësaj dite.

Kulmi i krizës jugosllave erdhi në momentin kur në krye të armatës jugosllave erdhi personi që realizoi shumë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, Slobodan Millosheviqi, i cili e shfrytëzoi këtë armatë për interesat serbe duke u munduar të gënjejë botën gjoja se mbron tërësinë territoriale të Jugosllavisë.

#### **4.2. Krimet kundër njerëzimit në Bosnjë Hercegovinë**

Në vitin 1992 në Londër u mbajt një konferencë nga ku filloi të del në shesh edhe fillimi i fundit të luftës së Kroacisë pasi që disa territore tanimë ishin fituar me anë të luftës. Armata serbe dukej se ishte shumë e kënaqur nga kjo luftë mirëpo nga ana tjetër ndjeheshin edhe të nënçmuar pasi që ishin të detyruar të pranojnë hyrjen e fuqive të mëdha ndërkombëtare, respektivisht të OKB-së në territoret e Kroacisë. Ky rezultat u monitorua nga njerëz të shumtë të cilët vëzhgonin zhvillimin e ngjarjeve në ish Jugosllavi gjegjësisht luftën në Kroaci dhe konstatuan se kjo tërheqje e forcave ushtarake të Serbisë nuk ndodhi rastësisht. Më vonë u kuptua se kjo lëvizje e Serbisë ishte taktike pasi që ata bëheshin gati që luftën ta transferojnë prej Kroacie në Bosnjë Hercegovinë. Ushtria federative, siç edhe njihej asokohe, e shfrytëzoi territorin e Bosnje Hercegovinës për të luftuar me Kroacinë edhe pse vetë Bosnja Hercegovina nuk ishte përfshirë drejtpërdrejtë në luftë, por siç përmendëm edhe më lartë brenda gjithë kësaj periudhe janë hartuar plane të ndryshme dhe të rëndësishme për të zhvilluar një luftë brenda territorit të Bosnjë Hercegovinës.

Siç edhe njihet Bosnja dhe Hercegovina përbëhet nga tre bashkësi etnike edhe atë boshnjak, kroat dhe serb, gjë që komplikon edhe më tepër një vendimmarrje të përbashkët pasi që nevojitet një vendim konsensual ku do të pajtoheshin të tria bashkësitë etnike. Kjo edhe më mirë shihet pasi që duke vëzhguar me vëmendje Slloveninë dhe Kroacinë të cilët me

ngulm kërkonin që të dilnin nga federata jugosllave në Bosnjë Hercegovinë këto kërkesa ishin të pa pranueshme shkak i mendimeve të ndara të bashkësive etnike.

Edhe përpos mendimeve të ndara të lartpërmendura të bashkësive etnike që edhe sot e kësaj dite përbëjnë shtetin e Bosnje Hercegovinës në vitin 1991 pikërisht Parlamenti i Bosnjës mori një vendim shumë të rëndësishëm ku kërkonin të dilnin nga përbërja e Federatës Jugosllave. Ky vendim rriti edhe problemet brenda territorit pasi që deputetët serb nuk e pranuan këtë vendim dhe në kohën kur duhej votuar ata lëshuan parlamentin. Rast tjetër që vlen të përmendet është edhe referendumi i mbajtur për pavarësinë e Bosnjë Hercegovinës në vitin 1992 edhe në këtë rast serbët ishin ata të cilët nuk e pranuan. Këto ngjarje lëkundën edhe politikën ndërkombëtare pasi që përplasën qëndrimet ndërmjet Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me marrëveshjen e Lisbonës e cila udhëhiqej nga Bashkimi Evropian. Në këtë marrëveshje ishte menduar që Republika e Bosnje Hercegovinës të funksiononte si një shtet sovran mirëpo të ndahej në tri kantone duke u bazuar në bazat etnike. Edhe pse nuk ishte përcaktuar asgjë konkrete as me sovranitetin e këtij shteti as me funksionimin e tij prapë se prapë SHBA dhe Bashkimi Evropian e njohën këtë krijesë shtetërore me ç'rast edhe serbët do të fillonin luftën me 6 dhe 7 Prill.

Lufta në Bosnjë njihet edhe si lufta më e ashpër e zhvilluar në territorin e ish Jugosllavisë me ç'rast edhe janë kryer shumë krime të rënda kundër njerëzimit gjë që ndikoi edhe në faktorin ndërkombëtar që të gjejnë një mënyrë për të reaguar në këtë territor respektivisht për të ndërprerë gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që për fat të keq morën përmasa të mëdha brenda territorit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Pas këtyre ngjarjeve makabre në luftë u përfshinë edhe vendet perëndimore me anë të NATO-s e cila mori në vendim të rëndësishëm që të ndërhyjë në territorin ku ishte duke u zhvilluar lufta dhe dërgoi një forcë ushtarake prej 10.000 personash që kishin për qëllim gjetjen e mundësisë për të arritur deri te paqja. Një diplomat i lartë i NATO-s dha një koment të shkurt mbi realizimin e këtij operacioni i cili tha: “ky është një hap i parë shumë i kujdesshëm, por mund të jetë një fillim për diçka më të madhe. Mund të thuhet se tani aleanca e Atlantikut ka një këmbë në derë”.<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> Intervenimi i Natos në Kosovë, Nusret Pllana, Prishtinë, 2010, faqe 44.

#### 4.2.1. Masakra e Srebrenicës

Duke u bazuar në historinë e luftërave ndërkombëtare tragjedia e ndodhur në qytetin e Srebrenicës edhe sot e kësaj dite mbetet si rasti më tragjik me padrejtësitë që janë bërë gjatë kërkimit të një zgjidhjeje të këtij rasti tragjik. Shumë studiues për këtë ngjarje fajtorë i llogaritin SHBA-të dhe Evropën Perëndimore.

Qyteti i Srebrenicës para fillimit të luftës kishte më shumë se 18.000 banorë mirëpo për një kohë të shkurtë numri i banorëve të Srebrenicës arriti në 42.000 kjo u bë si rezultat i asaj se Organizata e Kombeve të Bashkuara e cila në vitin 1995 forcat ushtarake i kishte vendosur në një bazë të tyre ushtarake pranë Potoçarit (që ishte shumë afër Srebrenicës), mori një iniciativë që të marrë në përkujdesje refugjatë musliman dhe i kishte vendosur në këtë qytet. Kjo zonë ishte shpallur si zonë e mbrojtur dhe sipas të Drejtës Ndërkombëtare banorët e kësaj zone të mbrojtur nuk kishin të drejtë të posedonin armë, dhe të njëjtëve u kishin premtuar se do të jenë të mbrojtur nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Pikërisht obligimi dhe detyra e Bashkësisë Ndërkombëtare që të mbrojnë 42.000 banorët e qytetit të Srebrenicës është edhe pika më diskutabile edhe sot e kësaj dite se pse nuk i mbrojtën qytetarët musliman të Srebrenicës. Me 6 Korrik të vitit 1995 filloi edhe sulmi i qytetit nga ana e forcave ushtarake serbe, që më 11 Korrik të po atij viti të kryhet edhe masakra më e madhe e ndodhur në Srebrenicë, ajo që ngelet enigmë edhe sot e kësaj dite është se përse forcat ndërkombëtare të OKB-së me vetëdije shkelën detyrën dhe obligimin e tyre dhe i lanë të pambrojturit në duart e ushtrisë serbe duke lënë kështu edhe kontrollin e gjithë qytetit në duart e policëve dhe paramilitarëve serb. Shume studiues të masakrës së Srebrenicës kanë konstatuar se e gjithë kjo ka ndodhur shkak se janë vëllazëruar ushtarët serb me ushtarët e Kombeve të Bashkuara. Shkalla e vëllazërimit dhe bashkëpunimit të këtyre dy ushtrive arriti deri në atë nivel sa që ushtarët e Kombeve të Bashkuara u ndihmonin serbëve që ti ndanin burrat musliman nga gratë. Numri i viktimave të dala nga masakra e Srebrenicës ishin marramendëse pasi që mendohet se diku afër 23.000 musliman ishin viktima të pastrimit etnik, gjithashtu dihet se gjatë kësaj tragjedie është bërë edhe vrasja e 10.000 burrave dhe djemve musliman boshnjak.<sup>46</sup> Fakt tjetër që të çon në padrejtësinë e studimit të kësaj masakre është edhe ajo se asnjëherë nuk janë diskutuar krimet kundër njerëzimit të kryera në qytetin e Srebrenicës kundrejt personave të cilët u ekzekutuan. Llojet

---

<sup>46</sup> Intervenimi i Natos në Kosovë, Nusret Pllana, Prishtinë, 2010, faqe 46.



e krimeve kundër njerëzimit që janë kryer në qytetin e Srebrenicës janë: tortura në mënyrë jo njerëzore dhe përdhunimet ndaj grave dhe vajzave numri i të cilëve asnjëherë nuk ka qenë i definuar, ku edhe sot e kësaj dite nuk dihet fati i atyre grave dhe vajzave. Edhe pse NATO-ja ndërhyri në luftën e Bosnjës, në qytetin e Srebrenicës ndodhi një masakër makabre e cila më vonë u përkufizua si gjenocidi më i rëndë i ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe sot e kësaj dite ekziston dilema se pse forcat e OKB-së reagues në atë mënyrë dhe mos vallë ka qenë thjesht një plan për ti grumbulluar 42.000 banorë të pafajshëm dhe për t'ua servuar paramilitarëve serb.

#### **4.2.2. Numri i viktimave nga Lufta e Bosnjë Hercegovinës**

##### **(sipas gjinisë, rajonit dhe komunave)**

- Sarajeva, kryeqyteti i Bosnjë Hercegovinës ishte i organizuar në dhjetë komuna, katër qendra dhe gjashtë komuna që ishin në rrethinë. Nga fillimi i luftës deri në fund, në Sarajevë gjithsejtë u vranë 13,952 persona ose 14,54% nga numri i përgjithshëm i viktimave në Bosnjë Hercegovinë. Prej numrit të viktimave gjithsejtë burra të vrarë në Sarajevë ishin 11,746 prej të cilëve 8,271 ushtarë dhe 3,475 civil, ndërsa gjithsejtë gra të vrara ishin 2,206 prej të cilave 117 ushtarë dhe 2,089 civile.
- Podrinje, një rajon i përbërë nga 16 komuna, ku bën pjesë edhe masakra e Srebrenicës, u vranë gjithsejtë 28,135 persona ose 29,32% nga numri total i të vrarëve nga gjithë Bosnja. Prej numrit të viktimave gjithsejtë burra të vrarë ishin 25,031 prej të cilëve 11,745 ushtarë dhe 13,286 civil. Numri i viktimave femra shkoi deri në 3,104 nga të cilat 75 ushtarë dhe 3,029 civile. Mund të thuhet se ishte një nga rajonet ku më ashpër u krizën luftimet dhe kemi numër më të madh të viktimave nga gjithë territori i Bosnjë Hercegovinës.
- Pounje, një rajon i përbërë nga gjithsejtë 12 komuna, gjithsejtë pati 14,359 viktima, ku pjesa më e madhe ishin burra edhe atë 7,320 ushtarë dhe 5,865 civilë, kurse numri i grave të vrara arriti deri në 1,174 nga të cilat 1,141 gra civile dhe 33 ushtarë. Vlen të theksohet se numri i të vrarëve në këtë rajon përbën 14,96% të viktimave totale të Luftës së Bosnjës.
- Rajoni i Posavinës mbulon në vete 16 komuna dhe numri i të vrarëve në këtë rajon mbush 13,58% të numrit të përgjithshëm të viktimave të luftës ose 13,033 persona. Gra

të vrara në këtë rajon gjithsejtë ishin 893 nga të cilat 52 ushtarë dhe 841 civile, kurse numri i burrave të vrarë kaloi në 12,140 ku 10,232 prej të cilëve ishin ushtarë dhe 1,908 civilë.

- Bosnja Qendrore pozita gjeografike e së cilës përfshin pjesën qendrore të vendit dhe përfshin në vete 19 komuna, dhe vdekjen e gjetën 11,290 persona ose 11,76% e viktimave të përgjithshme të luftës, prej të cilëve vlen të përmendet se 10,420 ishin bura edhe atë 9,111 ushtarë dhe 1,309 civilë. Ndërsa gjithsejtë u vranë 870 gra, prej të cilave 795 civile dhe 75 ushtarë.
- Rajoni i Vërbasit përfshin të gjithë komunat përgjatë lumit Vrbas dhe afër tij që gjithsejtë arrin në 15. Në këtë rajon gjatë luftimeve të ashpra gjithsejtë mbetën të vrarë 8,124 persona ose 8,46% e viktimave totale të luftës. Numri i burrave të vrarë shkon deri në 7,591 edhe atë 6,309 ushtarë dhe 1,282 civilë. Në këtë rajon u vranë 14 gra ushtarë dhe 519 gra civile ose thënë në përgjithësi 533 gra të vrara.
- Është rajoni i quajtur Neretva që në vete numëron 21 komuna, nga statistikat e pasluftës u konstatua se në këtë rajon janë vrarë total 6,702 persona edhe atë 1,417 burra civil dhe 4,195 bura ushtarë ose thënë në përgjithësi 5,666 bura të vrarë ngelën nga luftimet e këtij rajoni. Gra të vrara ngelën gjithsejtë 1,036 prej të cilave 35 ushtarë dhe 1,001 civile. Nëse krahasojmë me rajonet tjera, edhe pse dëmet janë shumë të mëdha por përqindja e të vrarëve total është me e ulët në krahasim me rajonet tjera edhe atë 6,98%.

Në vazhdim me anë të një table do të paraqesim numrin e përgjithshëm të viktimave nga lufta e Bosnjë Hercegovinës sipas rajonit dhe gjinisë së të vrarëve.<sup>47</sup>

Rajoni	Burra			Gra			Gjithësejt viktima
	Civil	Ushtarë	Gjithsejtë	Civil	Ushtarë	Gjithësejtë	
Sarajevë	3.475	8.271	11.746	2.089	117	2.206	<b>13.952</b>
Podrinjë	13.286	11.745	25.031	3.029	75	3.104	<b>28.135</b>

<sup>47</sup> Wikipedia

Pounje	5.865	7.320	13.185	1.141	33	1.174	<b>14.359</b>
Posavina	1.908	10.232	12.140	841	52	893	<b>13.033</b>
Bosnia Qendrore	1.309	9.111	10.420	795	75	870	<b>11.290</b>
Vrbas	1.282	6.309	7.591	519	14	533	<b>8.124</b>
Neretva	1.417	4.195	5.612	1.001	35	1.036	<b>6.648</b>
<b>Gjithësejt (sipas rajonit )</b>	<b>28.542</b>	<b>57.183</b>	<b>85.725</b>	<b>9.415</b>	<b>401</b>	<b>9.816</b>	<b>95.541</b>

### 4.3. Krimet kundër njerëzimit në luftën e Kroacisë

Lufta e Kroacisë që ndryshe njihet nga populli kroat si “*domovinski rat*” ndodhi për çlirim total të territorit të Republikës Kroate nga forcat dhe agresioni ekstremist i Serbisë. Në fillimin e sulmeve kundër Kroacisë, rol kryesor kishte ARMATA POPULLORE E JUGOSLLAVISË që asokohe njihej me emrin “*JUGOSLOVENSKA NARODNA ARMIJA*” e përbërë nga të gjithë shtetet anëtare në atë kohë të Ish Jugosllavisë. Kjo armatë për disa muaj u riorganizua në tri pjesë edhe atë:

- Armata serbe - krahinë e Kroacisë,
- Armata e Republika Serbskës në Bosnje Hercegovinë dhe
- Armata Jugosllave në territorin e Serbisë dhe Malit të Zi.

Luftën e Kroacisë mund ta klasifikojmë në tre etapa:

- Etapa e parë, nis me shkatërrimin e ish-Jugosllavisë dhe fillimin e rënies së komunizmit deri në vitin 1992.

- Etapa e dytë, fillon nga viti 1992 dhe zgjat deri në vitin 1995 dhe

- Etapa e tretë, fillon nga viti 1995 deri në Marrëveshjen e Dejtonit.

Gjatë etapës së parë, u realizua lufta e agresionit ndaj popullit kroat e cila ishte e detyruar të vetëmbrohet. Gjatë asaj periudhe kreu i shtetit kroat ndërmori disa hapa shumë të rëndësishëm për parandalimin e konfliktit dhe zgjidhjen e saj në rrugë politike dhe diplomatike, mirëpo një gjë e tillë ishte e pamundur. Në kohën kur filloi rënia e sistemit

komunist dhe brenda Jugosllavisë kishte mosmarrëveshje të shumta ndëretnike, armata popullore e Jugosllavisë e shfrytëzoi këtë moment duke armatosur etnitetin serb në Kroaci dhe etnitetin serb në Bosnjë Hercegovinë, duke ia rënduar kështu punën pushtetit kroat që të mos mund të kontrollojë territorin e Kroacisë. Konfliktet e armatosura filluan në vitin 1991 ku pakicat serbe që tanimë ishin të armatosur filluan të pushtojnë fshat pas fshati dhe qytet pas qyteti, vende këto ku pjesa më e madhe ishin të etnitetit serb. Në vendet e okupuara serbët realizuan një kryengritje dhe themeluan të ashtuquajturën “Republika Srpska Krajina” e cila asnjëherë nuk u pranua nga faktori ndërkombëtar. Milan Babiç, Goran Haxhiç dhe Milan Martić ishin tre kryetarët e atij të ashtuquajturit shtet, dhe të njëjtët pas përfundimit të luftës u dënuan me shumë vite burg duke u akuzuar për krime të rënda lufte dhe krime të rënda kundër njerëzimit gjegjësisht popullit civil.

Në etapën e dytë që siç e cekëm më lartë zgjati prej vitit 1992 deri në vitin 1995, erdh deri tek ulja e agresionit, hyrja në mes e faktorit ndërkombëtar me anë të UMPROFORIT dhe mundohej të gjendet një rrugë për çlirimin e vendeve të okupuara. Gjatë kësaj etape filloi lufta edhe në Bosnjë Hercegovinë gjatë së cilës vlen të ceket se lindi edhe një konflikt i ashpër ndërmjet boshnjakëve dhe kroatëve.

Etapa e tretë ishte ajo pas vitit 1995, ku falë disa operacioneve ushtarake nga ana e kroatëve, u çlirua pjesa më e madhe e Sllavisë dhe Dalmacisë. Disa muaj më vonë këto operacione ushtarake u realizuan edhe në Bosnjë Hercegovinë me ç’rast u mundësua edhe fillimi i bisedimeve në mënyrë paqësore dhe u arrit marrëveshja e Dejtonit e cila rezultoi me paqe.

Numri më i madh i viktimave, dëmet më të mëdha, krimet më të mëdha të luftës dhe krimet më të mëdha kundër njerëzimit u realizuan në etapën e parë apo më saktësisht gjatë vitit 1991 përgjatë së cilës u luftua për okupimin e Dubrovnikut dhe gjithë Sllavisë ku ndodhi edhe masakra e njohur e Vukovarit.

Për nga praktika realizimi dhe qëllimi, lufta e Kroacisë nuk dallonte aspak nga Lufta e Bosnjë Hercegovinës pasi që të dy palët armikun e kishin të njëjtë i cili kishte të njëjtin qëllim, realizimin apo krijimin e një të ashtuquajtur “Serbi të madhe”, gjë të cilën nuk patën fatin ta realizojnë asnjëherë, as sot e kësaj dite. Lufta në Kroaci nuk u realizua vetëm për okupimin e territorit kroat, por edhe për zhdukjen e popullit, kulturës dhe historisë kroate. Këtë më qartë e shpjegon edhe granatimi i katedrales në Shibenik dhe Zadër. Sipas disa të dhënave statistikore mendohet se janë granatuar diku mbi 180.000 objekte banimi dhe kanë

ngelur të vrarë dhe të zhdukur mbi 21.000 persona. Duke u bazuar në librin e kroatëve mbi evidencën e të vdekurve ka pasur gjithsejtë 21.118 viktima, prej të cilëve në anën e kroatëve ka pasur gjithsejtë 13.940 viktima ku 8.257 ishin ushtarë dhe 5657 ishin civil kurse 1.093 persona rezultojnë të zhdukur prej të cilëve 428 kanë qenë ushtarë dhe 665 civil. Në anën e serbëve ka pasur gjithsejtë 7.204 viktima dhe 900 persona të zhdukur, nga të cilët 5 kanë qenë ushtarë dhe 895 civilë. Lufta kishte përfshi rreth 54% të territorit të Kroacisë, ndërsa 26% e territorit ishte e okupuar. Në vijim të dhënat statistikore janë paraqitur në formë tabelore.

	Pjesa e Kroacisë			Pjesa e vendeve të okupuara			Gjithësejt viktima
	Ushtarë	civil	Gjithsejtë	Ushtarë	Civil	Gjithësejt	
<b>Viktima</b>	8257	5657	13914			7204	21118
<b>Të zhdukur</b>	428	665	1093	5	895	900	1993
<b>Gjithësejt</b>	<b>8685</b>	<b>6322</b>	<b>15007</b>	<b>5</b>	<b>895</b>	<b>8104</b>	<b>23111</b>

## PËRFUNDIMI

Rëndësia praktike dhe teorike e këtij punimi konsiston në analizën dhe sqarimin e hollësishëm të krimeve kundër njerëzimit si një nga format e shumta të veprave penale të cilat vijnë si pasojë e konflikteve mes popujve dhe shteteve. Sistemi i drejtësisë dënon çdo kryerës të veprave penale me ç'rast iu kushtua edhe një rëndësi e veçantë krijimit të gjykatave penale ndërkombëtare, si dhe një analizë krahasimore në përbërjen dhe funksionimin e tyre.

Punimi fillon me një historik të shkurtër për krimet kundër njerëzimit në përgjithësi si dhe trajtimi i tyre juridiko-penal. Vrasjet, shfarosjet, robërimi, masakrat, deportimi dhe shumë vepra tjera jonjerëzore janë konsideruar si krime kundër njerëzimit qysh në themelimin e gjykatës së parë penale ndërkombëtare në Tokio. Lloji i njëjtë i krimeve më vonë do të trajtohet edhe në gjykatën penale ndërkombëtare ushtarake në Nyrnberg, e më vonë edhe në gjykatën e Hagës e cila u themelua apostafat për krimet e dala nga territori i ish Jugosllavisë. Zanafilla dhe arsyeja kryesore për themelimin e këtyre institucioneve ndërkombëtare të drejtësisë ishte masakrimi i popullsisë në luftën turko-armene dhe krimet e panumërta kundër njerëzimit të kryera gjatë Luftës së Parë Botërore.

Në vazhdim të punimit jemi njohur edhe me krimet kundër njerëzimit të kryera në territorin e Kosovës gjatë viteve 1997-2000 e cila është edhe pikë studimi në këtë punim. E pamë qartë se populli shqiptar i Kosovës ka vuajtur shumë nga forcat paramilitare ushtarake serbe edhe para vitit 1997 e atë për fat të keq rezultoi me luftë. Mosrespektimi i rregullave të luftës nga ana e Serbisë solli deri te realizimi i disa masakrave makabre ku krimet ndaj popullatës civile ishin të panumërta dhe të shumëllojshme.

Në kapitullin e fundit të këtij punimi jemi njohur më hollësishme shkatërrimin e një fuqie të madhe Botërore siç ka qenë Jugosllavia, me Luftën në Bosnjë Hercegovinë dhe Kroaci, me krimet kundër popullit civil në këto dy shtete, me masakrat makabre, si dhe në mënyrë statistikore kemi paraqitur numrin e viktimave të dalë nga kjo luftë.

Duke u bazuar në fjalët dhe faktet e lartpërmendura lirisht mund të konstatojmë se krimet kundër njerëzimit kanë ekzistuar qysh në Luftën e Parë Botërore, dhe për fat të keq, përpos themelimit të Gjykatave Penale Ndërkombëtare, ato do të ekzistojnë sa të ekzistojë mbarë njerëzimi.

## BIBLIOGRAFIA

### Libra:

1. Altin Shegani: E Drejta Penale e Krahasuar, Tiranë, 2002.
2. Andre Hue, Rene Koerin-Zhulen, Megjunarodno kazнено pravo, Ars Lamina, 2013.
3. Antonio Kaseze: Megjunarodno krivično pravo, vtoro izdanie, Antonio Kaseze, Prosvetno Delo, 2009.
4. Antonio Kaseze, Megjunarodno krivično pravo, Antonio Kaseze, Ohrid 2008.
5. Bardhyl Mahmuti: Mashtrimi i madh, Shkup, 2015.
6. Bernd Heker: Evropso krivično pravo, Janar 2007, Skopje.
7. Ejup Sahiti, Ismail Zejneli: E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2017.
8. Grup autorësh, Golemite odluki na Evropskiot sud za çovekovite prava, Ars Lamina 2013.
9. Grup autorësh: Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009.
10. Ismet Salihu: E Drejta Penale Ndërkombëtare, Prishtinë, 2005.
11. Ismail Zejneli, Vlado Kambovski: E Drejta Penale pjesa e Përgjithshme, Tetovë, 2018
12. Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2007.
13. Kazнено pravo poseben del krivični dela protiv licnité i zednickite vrednosti, Johannes Vesels, Mihaell Hetinger, Tabernakul 2009.
14. Robert Krajer, Hakan Friman, Deril Robinson, Elizabet Vilmsherst, Voved vo megjunarodno krivično pravo i krivična procedura, 2010, Tabernakul.
15. Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publike, 2007, Prishtinë.
16. Rowena Murray, How to write a thesis, 2003, Maidenhead Philadelphia.
17. Martin, Francisco Forrest (2007). *The Constitution as Treaty: The International Legal*
18. *Constructionalist Approach to the U.S. Constitution*. Cambridge University Press
19. Praktika Penale Ndërkombëtare, Steven Powels, John R. W. D. Jones, 2003.
20. Baldwin, Cradock & Joy, The Parliamentary debates from the year 1803 to the present time... Vol. 32, 1 February - 6 March 1816.
21. M. Cherif Bassiouni, Crimes against Humanity: Historical Evolution and Contemporary Application, Cambridge University Press, 2011.
22. Kosova në vitet 1997-1999, Jakup Krasniqi

23. ‘Pas Dejtonit Kosova brengë e bashkësisë ndërkombëtare’, Shkup, 2005.
24. “Kosova dhe UÇK-ja”, Llama Kudusi, Tiranë 2005.
25. “Rruga e lirisë”, Nusret Pllana, Prishtinë 2000.
26. ”Jeta ime”, Bill Klinton, Tiranë 2005, faqe 715.

**Webfaqe:**

[www.avokaturaeshtetit.gov.al](http://www.avokaturaeshtetit.gov.al)

[www.mja.org.mk](http://www.mja.org.mk)

[www.osce.org](http://www.osce.org)

[www.pravdiko.mk](http://www.pravdiko.mk)

[www.shtetiweb.org](http://www.shtetiweb.org)

[www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)

[www.royalcollection.org.uk](http://www.royalcollection.org.uk)

[www.slideshare.net](http://www.slideshare.net)

[www.gazetatribuna.com](http://www.gazetatribuna.com)

[www.sq.wikipedia.org/wiki/Masakra\\_e\\_Re%C3%A7akut](http://www.sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Re%C3%A7akut) “Masakra e Reçakut”, Sheradin Berisha.

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra\\_e\\_Burgut\\_t%C3%AB\\_Dubrav%C3%ABs](https://sq.wikipedia.org/wiki/Masakra_e_Burgut_t%C3%AB_Dubrav%C3%ABs)

Wikipedia

**Ligje:**

1. Ligji për procedurë penale
2. Kushtetuta e RMV-së
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
4. Kodi Penal
5. Neni 2, 3, 4 i Statutit të Tribunalit të Ruandës.
6. Neni 3 i Statutit të Ruandës.
7. Neni 3 i Statutit të Ruandës
8. Neni 12-16 i Statutit të Gjykatës në Sierra Leone